

Emigrimet e popullsisë - një mundësi e pashfrytëzuar për zhvillim lokal në Kosovë





Ky punim trajton në veçanti Objektivën e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) 10 mbi zhdukjen e pabarazive.

Autor: Sami Behrami

Edituar nga: Ekipi i INDEP

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Gusht 2022

Dizajni: KUKU Creative



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Përmbajtja

Hyrje	5
1. Emigrimet e popullsisë dhe OZhQ-të e Agjendës 2030	6
2. Ndërlidhja mes migrimeve dhe zhvillimit lokal	8
2.1. Zhvillimi lokal dhe migrimi	9
2.2. Roli i emigrantëve në zhvillimin lokal dhe llojet e kapitalit	10
2.3. Roli i emigrimeve në zhvillimet lokale	11
3. Trendet e migrimeve dhe lindshmërisë në komunat mostra - Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas dhe Obiliq	12
3.1. Trendet e shtimit natyror dhe migrimeve	13
3.2. Trendet e emigrimeve 2011-2020	16
3.3. Emigrimet dhe ndikimi i tyre në sistemin arsimor	17
3.4. Emigrimet dhe varfëria	18
3.5. Emigrimet dhe urbanizimi	19
4. Roli i nivelit lokal në fuqizimin e emigrantëve	20
4.1. Fuqizimi i emigrantëve	20
4.2. Roli i vetëqeverisjes lokale në fushën e migrimeve dhe zhvillimit në Kosovë	21
4.3. Përfshirja e potencialit migrues në dokumentet strategjike komunale - gjendja në komunat Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas dhe Obiliq	23
4.4. Niveli lokal/komunal	23
4.5. Niveli qendror	24
5. Roli i autoriteteve lokale në integrimin e diasporës	26
5.1. Krijimi i kushteve për rintegrim të suksesshëm	26
5.2. Mundësitë e bashkëpunimit me diasporën dhe shfrytëzimi i potencialit për zhvillim lokal	27
5.3. Rëndësia e remitancave dhe investimeve për zhvillimin lokal	28
5.4. Bashkëpunimi me diasporën – udhëzimet e organeve komunale për përmirësimin e bashkëpunimit me diasporën	30
5.5. Aktivitete që synojnë forcimin e bashkëpunimit me diasporën	30
5.6. Institucionet (e mundshme) e nivelit lokal për bashkëpunim me diasporën	32
6. Sfidat kryesore për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit	33
7. Rekomandimet	36

Hyrje

Ekziston një gamë e gjerë faktorësh të cilët ndikojnë në progresin e Agjendës 2030, duke filluar nga ato të spektrit ekonomik, social dhe mjedisor. Tash e sa vite, emigrimi është një ndër realitetet e Kosovës nga i cili mund të merren shumë përfitime për shoqërinë kosovare. Ky i fundit mund të konsiderohet si një ndër nxitësit kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm, ku të emigruarve u jepet mundësia për të ngritur kapacitetet dhe aftësitë në fusha të caktuara dhe promovojnë kulturën e vendit duke u angazhuar në profesione të ndryshme dhe komunitete.

Pavarësisht se janë bërë përpjekje për përpilime të udhëzimeve me qëllim të krijimit të mekanizmave institucionalë për rritjen dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit lokal dhe diasporës, potenciali i këtyre të fundit në Kosovë nuk po shfrytëzohet si duhet si nga niveli lokal, ashtu edhe ai qendror, duke penalizuar kështu zhvillimin dhe promovimin e Kosovës në këto dy nivele. Andaj, qëllimi kryesor i këtij punimi është analizimi i gjendjes, roli dhe rëndësia e emigrimeve në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës me theks të veçantë në avancimin e Agjendës 2030.

Punimi trajton nëntemat si: emigrimet dhe zhvillimin lokal, lidhjen mes tyre, rolin e nivelit lokal në fuqizimin e emigrantëve, rolin e autoriteteve lokale në integrimin dhe rritjen e kontributit nga diaspora, mundësitë e bashkëpunimit me diasporën dhe shfrytëzimin e potencialit për zhvillim lokal, mekanizmat institucionalë për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes lokale me diasporën, sfidat kryesore për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit, trendet e emigrimeve dhe lindshmërisë në komunat mostra, etj. Gjithashtu, në përfundim janë dhënë edhe rekomandimet e nevojshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes në komunat e Kosovës.

Fuqizimi i emigrantëve për zhvillim lokal nënkupton krijimin e kushteve prej të cilave emigrantët bëhen nxitës efektivë të zhvillimit të qëndrueshëm në vendet e tyre të origjinës dhe destinacionit. Kur ata jetojnë në kushte dinjitoze, gëzojnë të drejtat e tyre dhe përfshihen në komunitet, prandaj emigrantët janë në gjendje të përdorin potencialin e tyre për zhvillimin e shoqërisë.

Gjithashtu, për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), emigrimet luajnë rol të rëndësishëm për përmbushjen e shumë nga caqet, prandaj me qëllim të maksimalizimit të efekteve pozitive të migrimeve janë të nevojshme edhe politikat adekuate të migracionit. Edhe agjenda tetë pikëshe për mbrojtjen e të drejtave të emigranteve në vitin 2013, *kërkon integrimin e migracionit në agjendat zhvillimore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm*.¹

Qëllimet specifike të punimit janë që të afrojnë temën e emigrimit me zhvillimin lokal në mënyrë që: 1) të krijohet një lidhje në mes emigrimit dhe zhvillimit lokal; 2) të thellohen format e bashkëpunimit me diasporën dhe shfrytëzimi i potencialit të diasporës për zhvillim lokal; 3) të angazhohen autoritetet vendore në fuqizimin e emigrantëve; 4) të integrohet dhe lehtësohet kthimi i profesionistëve të kualifikuar apo riintegrimi i të kthyerve; 5) të përfshihet potenciali emigrues në dokumentet strategjike komunale, etj.

Ky punim liston rekomandime konkrete për nivelin lokal me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në mes të njësive të vetëqeverisjes lokale me diasporën dhe krijimin e mekanizmave lokalë të cilat kontribuojnë në rritjen e përfitimeve që diaspora kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm në vendin e origjinës. Në analizimin e përfshirjes së emigrimeve në zhvillimin lokal në Kosovë, si mostra janë marrë 5 komuna të Kosovës, respektivisht: Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Drenasi dhe Obiliqi (të përzgjedhura me metodën e rastit), të cilat mund të shërbejnë si pasqyrë edhe për përafrim të vlerësimit të gjendjes në komunat tjera.

Rezultati më i rëndësishëm i këtij punimi është që mund të shërbej si udhërrëfyes dhe të jetë i dobishëm për qeverisjen lokale në Kosovë, në funksion të informimit me mënyrat dhe zgjidhjet drejt krijimit dhe thellimit të bashkëpunimit me diasporën dhe shfrytëzimi i potencialit në dobi të zhvillimit ekonomik të komunave.

¹ OKB. (2013). "Making migration work: an eight-point agenda for action". E qasshme në anglisht në: https://www.un.org/en/ga/68/meetings/migration/pdf/migration_8points_en.pdf (E qasur në korrik 2022)

1. Emigrimet e popullsisë dhe OZhQ-të e Agjendës 2030

Në të gjithë botën, lëvizja e popullsisë është karakteristike për shoqërinë prej shumë kohësh. Gjatë gjithë historisë së zhvillimit, lëvizjet migruese ishin të nxitura nga një varg faktorësh ekonomik, social dhe politik, të cilat ishin të kushtëzuara dhe lidhura në kohë dhe vende të caktuara. Lidhjet pozitive në mes nivelit të zhvillimit ekonomik (p.sh. varfëria, problemet ekonomike, papunësia, etj.), në njërën anë, dhe lëvizjeve migruese të popullsisë në anën tjetër, tregojnë se faktorët ekonomikë janë kryesorët, por jo të vetmit të cilët ndikojnë në lëvizjet migruese duke i shndërruar migrimet në një proces kompleks.

Migrimet mund të ndahen në bazë të disa kriterëve, si sipas:

1. Hapësirës që përfshin: të brendshme (brenda shtetit) dhe të jashtme (në mes shteteve);
2. Kohës së përfshirjes: ditore, javore, mujore, sezonale, përkohshme dhe përhershme;
3. Motivit ose shkaqeve: ekonomike dhe joekonomike;
4. Vullnetit: vullnetare ose të dhunshme;
5. Organizimit: organizuara dhe të paorganizuara (stihike).

Lëvizja e popullsisë përfshin vendin e prejardhjes (vendin e mëparshëm të banimit) dhe vendin e ardhjes, prandaj për këtë arsye migrantet ndahen në emigrant (shkuarje) dhe imigrant (ardhje). Të gjitha llojet e migrameve kanë efekte të dyfishta, së pari në vendin e prejardhjes dhe së dyti në vendin e ardhjes, me ndikim në ndryshimin e popullsisë së përgjithshme, shpërndarjen e strukturave të popullsisë, zhvillimin ekonomik, etj.

Si fenomen shoqëror, migrimet e popullsisë, për shkak të masivitetit në ditët e sotme, mund të konsiderohen si procese botërore duke u bazuar në evidenca dhe statistika. Ky proces sipas statistikave të OKB-së nga viti 2019, në formë të ndryshme janë përfshirë me tepër se 1 miliardë banorë (çdo i 6-ti banor) prej të cilëve 272 milion (ose 3.5% të popullsisë së përgjithshme të planetit) i takojnë grupit të migrameve ndërkombëtare. Nga këta numra, afërsisht gjysma janë gra, çdo i dhjeti emigrant është nën moshën 15 vjeçare, 4 nga 10 emigrant jetojnë në vendet në zhvillim dhe rreth 62% i takojnë emigrantëve ekonomik².

Mungesa e stabilitetit politik dhe dallimet në nivelin e zhvillimit ekonomik në mes të shteteve janë faktorë të rëndësishëm në rritjen e fluksit të migrameve politike dhe ekonomike. Kështu, gjatë periudhës 1990 – 2000, numri i migrameve ndërkombëtare është rritur për rreth 21 milion, për të vazhduar me këtë tendencë të rritjes në periudhën 2001 - 2010 me rreth 46.2 milion, ndërsa vetëm gjatë viteve 2011 – 2019, ky numër u rrit edhe për 51.5 milion emigrantë³. Nga numri i përgjithshëm i migrameve ndërkombëtare mbi 60% vijnë nga vendet në zhvillim.

Emigrimi i popullsisë nga Kosova në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Kosova gjatë gjithë shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI ishte dhe mbeti territor tipik emigruar. Shkaktarët kryesorë të cilët detyruan popullsinë të emigroj ishin dhe mbeten: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkatërrimet nga luftërat, situata jo e favorshme politike, ndërtimi i sistemit bazuar në kriteret partiake dhe nepotizëm duke mënjanuar meritokracinë dhe vlerat në ndërtimin e sistemit, etj.

Megjithatë, arsyeja kryesore për emigrim mbetet pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës për perspektivën e së ardhmes socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies e cila manifestohet me shkallë të lartë të papunësisë (sidomos në mesin e të rinjve) dhe përqindje të lartë të njerëzve që jetojnë në varfëri. Andaj, çështjet ekonomike që lidhen me papunësinë dhe varfërinë janë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Kosovës. Hulumtimet e fundit të opinionit tregojnë se këto dy parametra ekonomik janë edhe kërcënime të sigurisë kombëtare me të cilat përballet Kosova. Sipas këtyre të dhënave rreth 70% e të anketuarve besojnë se shkalla e lartë e

² "International Migration 2019- Report", Department of Economic and Social Affairs-Population Division, United Nations, New York, 2019, fq 3-10.
https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/publications/migrationreport/docs/InternationalMigration2019_Report.pdf

³ "International Migration 2019- Report", Department of Economic and Social Affairs-Population Division, United Nations, New York, 2019, fq 4-10.
https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/publications/migrationreport/docs/InternationalMigration2019_Report.pdf

papunësisë është kërcënimi më i madh për Kosovën⁴. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe numrin e madh të njerëzve që jetojnë në nivelin e varfërisë, emigrimi shihet si mundësi nga qytetarët e Kosovës për të gjetur një perspektivë më të mirë shoqërore dhe ekonomike jashtë vendit duke i shndërruar emigrimet edhe në rrezik për zhvillimet demografike, socio- ekonomike dhe të sigurisë në vend.

Edhe pse ekzistonte bindja se me lirin dhe pavarësinë e Kosovës do të zbuteshin flukset e emigrantëve, numrat fatkeqësisht vazhduan të jenë të përmasave shqetësuese edhe pas periudhës së luftës së vitit 1999. Sipas statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm në periudhën 2000 - 2020, Kosovën e kanë braktisur 380,033 banorë me mesatare prej mbi 19,000 banorë brenda vitit. Por, kontingjenti i emigrantëve pa dyshim që është edhe më i madh sesa këta numra, kur dihet fakti i emigrimeve ilegale të kosovarëve dhe emigrimi me pasaporta të vendeve tjera.

Akoma më shqetësuese është fakti se, bazuar në sondazhe të ndryshme të realizuara në vend, mbi 50% e të anketuarve kanë shprehur dëshirën të ikin nga Kosova prej të cilëve kryesisht gjenerata të reja (20 deri në 40 vjeç), të cilët përbëjnë kontingjentin kryesor demografik dhe të lindshmërisë, kontingjentin e punës, të sigurisë, etj., duke shkaktuar rënie të *kapitalit njerëzor*, si bartësin kryesor të zhvillimit socio-ekonomik.

Migrimi i popullsisë do të jetë tipari përcaktues i zhvillimeve demografike të shekullit XXI, të cilat kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha aspektet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, dhe si i tillë do të jetë thelbësor për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm në mënyrë të veçantë thekson kontributin e migracionit për ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Lidhja midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe rolit të migracionit është e rëndësishme për të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm. Fakti që migracioni është i rëndësishëm për 10 nga 17 OZhQ-të⁵ dhe shumicën e 169 synimeve tregon për rolin dhe rëndësinë e migrimeve në përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030.

Agjenda 2030, specifikisht në OZhQ 10, caku 10.7, kërkon: "lehtësimi i migrimit dhe lëvizshmërisë së rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshme të njerëzve, përfshirë këtu zbatimin të politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë të migracionit"⁶. Fakti që migrimet janë të rëndësishme për përmbushjen e shumicës së OZhQ-ve, i bënë emigrimet jo vetëm nevojë, por edhe domosdoshmëri të trajtimit dhe përfshirjes me qëllim të arritjes së përmbushjes së Agjendës 2030.

Një konfirmim tjetër i kësaj lidhjeje të ngushtë midis OZhQ-ve dhe migracionit është fakti që emigrantët, refugjatët dhe personat e zhvendosur janë grupe të njerëzve në nevojë, nevojat e të cilëve duhet të adresohen në mënyrë që "askush të mos lihet prapa", që është një nga parimet kryesore të Agjendës 2030 të OKB-së. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve në vitin 2013 është hartuar agjenda tetë pikëshe, e cila i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar që të përmirësojë nivelin e mbrojtjes së të drejtave për të gjithë migrantët, të ulë kostot e migracionit, t'i jepet fund shfrytëzimit të emigrantëve, të trajtohet gjendja e emigrantëve në vështirësi, të përmirësojë perceptimin publik të emigrantëve, të integrojë migracionin në agjendat zhvillimore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm, të fuqizojë bazën e dëshmitë të migrimit dhe të thellojë partneritete dhe bashkëpunime rreth migrimit.

Agjenda 2030, migrimet e popullsisë, sidomos ato ndërkombëtare, i trajton si mundësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendeve të origjinës, transitit dhe destinacionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Por, vetëm nëse ato menaxhohen mirë dhe përcillen me masa e politika të mirëfillta të cilat në Kosovë fatkeqësisht mungojnë dhe kanë ndikuar që, përveç remitencave, efektet pozitive të migrimeve në sferën e zhvillimit në Kosovë të jenë minimale, kurse efektet negative janë shumë më të mëdha duke filluar nga zhvillimet demografike, socio-ekonomike dhe të sigurisë në vend⁷. Me qëllim të shndërrimit të emigrimeve në potencial zhvillimor në vazhdimësi është bërë

⁴ Behrami S. (2019). "Emigrimet! A po rrezikohet Kosova nga ky fenomen?". Kosova Sot. E qasshme në: <https://www.kosova-sot.info/opinione/431875/emigrimet-a-po-rrezikohet-kosova-nga-ky-fenomen/> (e qasur në gusht 2022)

⁵ OZHQ(17) të cilat preken nga migracion janë: Objektiva 1, 2, 3, 4, 5, 8, 10, 11, 16 dhe 17.

⁶ OKB. OZhQ 10. E qasshme në anglisht: <https://sdgs.un.org/goals/goal10> (E qasur në korrik 2022).


⁷ Behrami S., Bajraktar F. (2021). "Dimensioni Demografik i Agjendës 2030 - Perspektivat dhe Sfidat e Kosovës". Faqe 32-33. Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Prishtinë. E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2021/07/INDEP_Dimensioni-i-Demografikes-se-Agjendes-2030_14072021.pdf (E qasur në gusht 2022).

përpjekje për ilustrimin e rrugëve të cilat pushteti lokal duhet ndjekur me qëllim të fuqizimit të tyre për zhvillim lokal.

2. Ndërlidhja mes migrimeve dhe zhvillimit lokal

Lidhja e ngushtë në mes zhvillimit ekonomik dhe migrimeve ka kohë që është evidentuar, megjithatë rëndësi akoma më e madhe kësaj lidhjeje i është kushtuar në dy dekadat e fundit, duke njohur kontributin e migrimeve edhe nga politikbërësit dhe komuniteti i donatorëve (sidomos atyre ndërkombëtare), në zhvillimin e vetë emigrantëve - njohuritë dhe aftësitë e tyre, zhvillimin e komuniteteve ku ata shkojnë, por edhe zhvillimin e familjeve dhe komuniteteve nga ku largohen.

Duke konstatuar peshën e kësaj lidhjeje migrime - zhvillim ekonomik, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2006 dhe 2013 me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve hartoi agjendën tetë pikëshe e cila i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar që të integroj migracionin në agjendat zhvillimore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm⁸ dhe të thellojë partneritetet dhe bashkëpunimin rreth migrimi. Përfshirja e migracionit në politikat zhvillimore ishte rekomandim edhe i Komisionit Global për Migracionin Ndërkombëtar (The Global Commission on International Migration)⁹.



Grafiku 1. Kontributet e emigrantëve në zhvillimin lokal

Në grafikun më lartë paraqiten qartë kontributet potenciale të emigrantëve në zhvillimin lokal dhe mund të shihet se emigrantët janë potencial i rëndësishëm i ndryshimit dhe zhvillimit të shoqërisë. Megjithatë, praktikat e shumta ndërkombëtare kanë treguar se akterët e qeverisjes lokale luajnë rol kyç në nisimat dhe qëndrueshmërinë e lidhjes migrim - zhvillim, ashtu siç theksohet edhe nga Nisma e Përbashkët për Migration dhe Zhvillimit (ANG: Joint Migration and Development Initiative - JMDI). Kjo për faktin se ndikimi dhe pasojat e migrimeve fillimisht ndihen në nivelin lokal qoftë kur bëhet fjalë për integrimin, kushtet e tregut të punës apo krijimin e mundësive për krijimin e bizneseve nga emigrantët. Për këtë arsye, lidhja në mes migrimeve dhe zhvillimit më së miri planifikohen dhe zgjidhen nga qeverisja lokale, kjo edhe për faktin se autoritetet lokale janë më afër dhe në pozitë më të mirë për t'u përgjigjur ndikimeve dhe sfidave të migracionit, qoftë për anët negative të kësaj dukurie ose edhe për përfitimet që sjellin emigrimet për nivelin lokal.

⁸ OKB. (2013). "Making migration work: an eight-point agenda for action". E qasshme në anglisht në: https://www.un.org/en/ga/68/meetings/migration/pdf/migration_8points_en.pdf (E qasur në gusht 2022)

⁹ Global Migration Group. (2010). Mainstreaming Migration into Development Planning- A Handbook for Policymakers and Practitioners.

Me qëllim të përfshirjes së diasporës në zhvillimet lokale është e nevojshme ndërmarrja e disa hapave konkret nga qeverisjet lokale, siç mund të jenë:

- Lobimi dhe avokimi në institucionet dhe komunitetin lokal që të krijohen të gjitha parakushtet teknike dhe të sigurohet:
 - Mënyrat më të lehta për marrjen e të gjitha lejeve,
 - Krijimi i rrugëve të komunikimi dhe transparencës dhe
 - Emërimi i punonjësve profesionist që do të jenë drejtpërdrejt të kyçur në krye të kësaj fushe.
- Fushatë gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar e cila do të synonte grupe të ndryshme: media, diasporë, qytetarët, komunitetin lokal, etj. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme me qëllim të krijimit të imazhit pozitiv për mundësitë e investimit në vendlindje nga përfaqësuesit e diasporës.
- Institucionet e nivelit lokal, por edhe atij qendror, duhet të ndryshojnë qëndrimin ndaj diasporës pasi që nga dokumentet strategjike të konsultuara në të dy nivelet kuptohet fakti sesa pak i kushtohet vëmendje dhe trajtohet roli i diasporës në zhvillimin ekonomik.
- Promovimi i projekteve të suksesshme që janë realizuar nga përfaqësuesit e diasporës në vendlindje dhe inkurajimi i investimeve tjera.
- Përfshirja e diasporës në planifikimin e zhvillimit lokal duke filluar nga faza përgatitore, përgatitja e dokumenteve strategjike zhvillimore, konsultimet, prezantimi dhe përcaktimi i masave dhe prioriteteve zhvillimore.
- Me rastin e planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve strategjike zhvillimore, diaspora duhet të përfshihet përmes identifikimit, emërimit dhe përfshirjes së personit/personave përgjegjës për diasporën nga vetëqeverisja lokale në formimin dhe përgatitjen e ekipeve zhvillimore.¹⁰

Këto hapa mund të zbatohen nëse kemi në dispozicion bazën e të dhënave të diasporës, e cila mund të arrihet përmes komunikimit proaktiv dhe ftesave për anëtarët e diasporës për pjesëmarrje përmes rrugëve tjera (në faqen zyrtare të komunës dhe në media përmes rrjeteve sociale, etj.). Me rastin e përfshirjes së diasporës në ekipet zhvillimore lokale duhet t'i kushtohet rëndësi tri elementeve kryesore që janë:

- a) të jenë profesionistë në fushat strategjike zhvillimore - ekonomike, sociale, mjedisore, publike, shërbimet dhe infrastruktura,
- b) të përfaqësojnë sektorë të ndryshëm - sektorin publik, privat, civil dhe akademikë (nëse janë aktiv në këta sektorë jashtë dhe/ose në komunitet), dhe
- c) brenda mundësive të përfaqësohen në mënyrë adekuate sipas gjinisë dhe moshës.

Në situatën konkrete në të cilën ndodhen institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës (duke u bazuar edhe në dokumentet zhvillimore) është e nevojshme rishikimi i dokumenteve zhvillimore me qëllim të përfshirjes së përfaqësuesve të diasporës si anëtarë të ekipit lokal të zhvillimit, si dhe trajtimi i diasporës si potencial zhvillimor konform kapacitetit dhe mundësive të saj.

2.1. Zhvillimi lokal dhe migrimi

Edhe në Kosovë sikurse në shumë vende tjera qasja ndaj migrimeve dhe zhvillimit zakonisht është detyrë dhe obligim i adresuar në nivel kombëtar, ku konceptohen dhe zbatohen politikat në fushën e migrimit dhe zhvillimit. Kjo është në përputhje me perceptimin se migrimi i nënshtrohet sovranitetit kombëtar, duke përfshirë marrëveshjet në mes vendeve dhe respektimin e konventave ndërkombëtare.

Megjithatë, qasja në nivel kombëtar nuk paraqet realitetin i cili ekziston në diversitetin e zhvillimit dhe kontekstit migrator që ekzistojnë brenda vendeve, e nxitur kjo nga pabarazitë të cilat ekzistojnë jo vetëm midis vendeve, por edhe brenda vendeve duke krijuar kështu edhe kontekstin lokal të emigrimeve edhe brenda vendit. Kjo është arsyeja pse lidhjet midis migrimit dhe zhvillimit kanë nevojë për një qasje integrale nga poshtë-lart, pra nga niveli lokal i cili fatkeqësisht shpesh

¹⁰ Agjencia për Shërbimin Civil e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. "Përfshirja e Diasporës në Zhvillimin Lokal". E qasshme në gjuhën boshnjake në: <http://www.obuke.adsfbih.gov.ba/index.php/kljucni-dokumenti/kljucni-dokumenti/najcesce-postavljena-pitanja-na-edukacijama/ukljucivanje-dijasporu-u-lokalni-razvoj> (E qasur në gusht 2022)

here anashkalohet, siç është rasti edhe në Kosovë, duke i shndërruar emigrimet nga *një mundësi shumë e madhe zhvillimore në përfitim shumë të vogël*, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Shfrytëzimi i përfitimeve të migracionit për zhvillimin lokal kërkon gjithashtu mbështetje politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në dekadat e fundit, duke pasur parasysh dimensionin lokal të migracionit dhe sukseset e treguara në praktikë, në shumë vende autoritetet lokale dhe rajonale po kthehen në akterë vendimtarë në qeverisjen e migracionit.

Si mund të optimizohet ky ndikim?

Tani më shumë raste tregojnë se kontributi i emigrantëve në zhvillimin lokal varet në masë të madhe nga marrëdhëniet të cilat vendosin në mes akterëve lokalë me emigrantët dhe nga sistemi i qeverisjes që ekziston në nivel lokal. Për këtë arsye, mangësitë institucionale lokale mund të pengojnë potencialin zhvillimor të emigrantëve. Prandaj është thelbësore që institucionet e qeverisjes në nivel lokal të krijojnë një mjedis të favorshëm dhe gjithëpërfshirës duke u ofruar emigrantëve hapësirë për t'ju dëgjuar mendimet dhe idetë e tyre, duke vendosur korniza transparente që rrisin besimin midis palëve të interesuara lokale dhe shoqatave të emigrantëve.

Është e qartë se autoritetet vendore do të kenë më shumë hapësirë për të vepruar në një vend të decentralizuar sesa në një vend ku të gjitha vendimet merren në nivel qendror¹¹.

2.2. Roli i emigrantëve në zhvillimin lokal dhe llojet e kapitalit

Emigrantët janë urë lidhëse midis vendeve të origjinës dhe vendit të destinacionit të cilët munden të nxisin dialogun ndërmjet këtyre dy vendeve si rezultat i lidhjeve që ata ruajnë me vendlindjen, duke transferuar përvojën dhe njohuritë e tyre dhe burimeve financiare që mund të përmirësojnë situatën në vend. Në këtë mënyrë, ata mbështesin dhe inkurajojnë bashkëpunimin me ide zhvillimore në vendin e origjinës.

Migrimi ndërkombëtar në zhvillimin lokal kontribuon përmes qasjes së njohur si 3T, që nënkupton tri tipa transferimi:


1. Transferimi i kapitalit social - rrjetet e emigrantëve,
2. Transferimi i njohurive – ekspertiza,
3. Transferimi i burimeve financiare – remitencat të cilat kanë dimension zhvillimor duke i kthyer emigrantët në element shumë të rëndësishëm të ndryshimit, gjegjësisht potencialit zhvillimor të shoqërisë duke përfshirë në radhë të parë nivelin lokal të qeverisjes.

Llojet e kapitalit të emigrantëve

Emigrantët, sikur edhe kategoritë tjera të shoqërisë, posedojnë aftësi njerëzore, sociale, financiare dhe kulturore, të cilat zhvillohen, përmirësohen dhe pasurohen gjatë përvojës së tyre të emigrimit. Aftësia dhe motivi i tyre për integrim në komunitetin pritës në njërën anë, dhe angazhimi i tyre në ruajtjen e lidhjeve me vendin e tyre të origjinës nga ana tjetër i shndërron emigrantët në akterë të cilët ndikojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin lokal të të dy komuniteteve. Pikërisht, kjo natyrë e dyfishtë është edhe arsyeja pse emigrantët quhen ura që lidhin shoqëritë, ekonomitë dhe kulturat e vendeve të origjinës dhe destinacionit të cilat thellohen nëpërmjet lidhjeve fizike, historive, përvojave dhe praktikave të tyre.

Të gjitha këto elemente janë të rëndësishme të cilat u japin emigrantëve legjitimitetin për t'u njohur, pranuar, trajtuar dhe mbështetur si akterë të rëndësishëm të zhvillimit lokal dhe si të tillë të përfshihen në të gjitha dokumentet strategjike zhvillimore të nivelit lokal (dhe jo vetëm).

¹¹ Nisma e Përbashkët për Migracion dhe Zhvillim (JMIDI). "Moduli hyrës mbi migracionin dhe zhvillimin lokal". Faqe 8-9. E qasshme në gjuhën angleze në: <https://returnandreintegration.iom.int/en/learning/e-courses/my-jm-di-e-toolbox-migration-and-local-development> (E qasur në gusht 2022).



Grafiku 2. Llojet e kapitalit të emigrantëve

Në nivel lokal ekzistojnë edhe dy lloje të kapitalit të emigrantëve të cilët më tepër i takojnë aspektit territorial e që lidhen me kapitalin social dhe kulturor dhe që janë:

- kapitali shpirtëror që përfaqëson lidhjen emocionale të emigrantit dhe përcakton gatishmërinë e emigrantit për të mbajtur lidhje me vendlindjen duke shqyrtuar edhe mundësitë për t'u kthyer përfundimisht, dhe
- kapitali lokal përfshin njohuritë e emigrantëve për nevojat zhvillimore lokale dhe i cili intensivkohet atëherë kur emigrantët kanë lidhje të fuqishme me vendlindjen.


Megjithatë, sfida kryesore e përfshirjes së emigrantëve në zhvillimin lokal varet nga dëshira dhe vullneti i tyre për të qenë nxitës të zhvillimit lokal, mundësive dhe kapaciteteve që u ofron vendlindja dhe pikërisht këtu shihet roli i pushteteve lokale në lehtësimin ose edhe mënjanimin e këtyre sfidave.

2.3. Roli i emigrimeve në zhvillimet lokale

Niveli lokal është segmenti i parë në hierarkinë administrativo-territoriale që i ndjen efektet e emigrimit, qofshin ato pozitive ose negative, duke përfshirë njësitë administrative lokale, zhvillimet demografike, efektet në tregun e punës, sistemin arsimor, etj. Prandaj, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e nevojshme analizës dhe rolit që mund të luajnë nivelet e qeverisjes në krijimin e efekteve pozitive të migracionit në zhvillim.

Roli i emigrimeve në zhvillimin ekonomik, qoftë në nivel lokal apo atë nacional, paraqet sfidë, por edhe mundësi për pushtetin vendor që përmes programeve dhe strategjive zhvillimore t'i kthejë emigrimet në mundësi zhvillimi. Me fjalë të tjera, politikat lokale që përfshijnë emigrimin si komponent të zhvillimit në dokumentet e tyre strategjike duke krijuar një mjedis të favorshëm për kapitalin migrator do të karakterizohen me zhvillim më intensiv të njësive.

Fatkeqësisht, Kosovës, si në nivelin nacional ashtu edhe në atë lokal, i mungojnë politikat e mirëfillta sa i përket shfrytëzimit racional dhe përfshirjes së emigracionit dhe strategjitë zhvillimore që e minimizon rolin dhe rëndësinë e emigrimeve në zhvillimin e vendit dhe njësive përbërëse të saj.



Grafiku 3. Fazat e zhvillimit të emigrimit

Gjatë secilës prej këtyre katër fazave të paraqitura më lartë, detyra e autoriteteve lokale është që të ndërmarrë aktivitetet konkrete në përgjigje të sfidave nga emigrimi për zhvillimin e komunitetit me fushata informuese me qëllim të njohjes së emigrantëve me mënyrat e ofrimit të shërbimeve, shërbimet e informacionit dhe qendrave të informacionit dhe këshillimit, ofrimi i shërbimeve elektronike, linjave telefonike informuese, takimet në terren, etj.


Migrimi është një çështje ndër-sektoriale që prek dhe ndikohet nga politikat në shumë sektorë të qeverisjes, duke përfshirë shëndetin, arsimin dhe aksesin në drejtësi, prandaj edhe qasja gjatë secilës fazë të zhvillimit të emigrimit duhet të jetë ndër-sektoriale.

3. Trendet e migrameve dhe lindshmërisë në komunat mostra - Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas dhe Obiliq

Përkundër peshës dhe rëndësisë së rritjes së migrameve, statistikave të lëvizjes të popullsisë janë të kufizuara dhe të mangëta krahasuar me statistikave tjera të popullsisë, konkretisht me statistikave vitale pavarësisht se edhe në këtë drejtim në dekadën e fundit janë bërë përparime të konsiderueshme. Kufizimet dhe mangësitë e statistikave të migrameve, posaçërisht, janë të shprehura me rastin e migrameve të jashtme.

Burimi kryesor i statistikave të migrameve (edhe migrameve të jashtme) është regjistrimi i popullsisë dhe vlerësimet e popullsisë nga ASK. Numri i përgjithshëm i popullsisë pasqyron ndryshimet që ndodhin në dinamikën dhe strukturat e popullsisë së një territori në kohë të caktuar, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm si lindshmëria, vdekshmëria, emigrimet, imigrimet, luftërat, epidemitë, etj., duke bërë kështu lëvizje të dukshme në numër të saj.

Bazuar në trendin e lindshmërisë, vdekshmërisë, migrameve dhe imigrimeve mund të konstatohet se komunat e analizuara karakterizohen me stagnim të popullsisë. Megjithatë, përderisa popullsia e komunave Mitrovicë, Vushtrri dhe Obiliq në dekadën e fundit karakterizohen me tendencë të zvogëlimit, komuna e Skenderajt dhe Drenasit karakterizohen me trend shumë të ulët të rritjes.



Grafiku 4. Ndryshimet e numrit të përgjithshëm të popullsisë në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas dhe Obiliq 2011-2020¹²

Bazuar në regjistrimin e popullsisë 2011 dhe vlerësimet e ASK-së mund të konstatohet se më 31 dhjetor 2020, komuna e Obiliqit kishte rënie të popullsisë prej -16.3%, komuna e Vushtrrisë -10.7% dhe e Mitrovicës prej -4.5%, ndërsa komuna e Drenasit kishte rritje prej 3.4% dhe Skenderaj 2.8%¹³.

3.1. Trendet e shtimit natyror dhe migrimeve

Në periudhën 2011 - 2020, shumica e komunave të Kosovës karakterizoheshin me shtim natyror pozitiv (numri i lindjeve më i lartë sesa i vdekjeve edhe pse lindshmëria krahasohet me rënje të shpejtë), mirëpo është e dukshme se në zvogëlimin dhe stagnimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë kanë ndikuar emigrimet e popullsisë.

Trendet e lindshmërisë

Në vitin 2020, në Kosovë është regjistruar numri më i vogël i lindjeve që nga viti 1920, respektivisht 1939. Numri i të lindurve në Kosovë në periudhën 2011 - 2020 është zvogëluar nga 27,626 (2011) në 21,925 (2020)¹⁴, që nënkupton rënie për 5,701 lindje ose -20.6% apo zvogëlim për 1/5 e numrit të lindjeve për periudhën 10 vjeçare.

Në periudhën 2011 - 2020, numri i lindjeve ka treguar rënie për -25.8% në Mitrovicë, -10.1% në Vushtrri, -19.3% në Skenderaj dhe -22.4% në Drenas. Vetëm komuna e Obiliqit në raport me vitin 2011 karakterizohet me rritje pozitive prej 6.8%, edhe pse kjo mund të jetë si pasojë e grumbullimit të lindjeve (nga viti paraprak si rezultat i pandemisë), meqenëse në raport në vitin 2019 edhe kjo komunë kishte rënie të numrit të lindjeve për -33.4%.

Në të njëjtën periudhë, numri i vdekjeve në të gjitha komunat ka treguar trende të shpejta të rritjes, respektivisht për 97.3% në Mitrovicë, 82.5% në Vushtrri, 99.4% në Skenderaj, 35.6% në Drenas dhe 106.4% në Obiliq. Nga të dhënat e prezantuar shihet se me përjashtim të Drenasit në të gjitha komunat tjera kemi gatit dyfishim të numrit të vdekjeve në vitin 2020 në raport me vitin 2011.

Në vitin 2019 në raport me vitin 2011 vdekshmëria kishte treguar trende të rritjes për 21.3% në Mitrovicë, 43.8% në Vushtrri, 44.1% në Skenderaj, 9.9% në Drenas dhe 5.5% në Obiliq. Nëse


¹² "Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse.

Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë>


¹³ "Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Sqarim: në raport me vitin 2011 në vitin 2020, rreth 40% e komunave të Kosovës kishin rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë.

¹⁴ "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2021", Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Prishtinë 2021, fq. 57. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/6800/vjetari-statistikor-2021f.pdf>

krahasohet raporti i vdekjeve të vitin 2020 dhe 2019 me ato të vitit 2011 do të shihet se ndikimi i pandemisë në rritjen e rasteve të vdekjes në të gjitha komunat ishte i konsiderueshëm.




Grafiku 5. Shtimi natyror dhe bilanci i migrimeve në Mitrovicë 2011-2020¹⁵




Grafiku 6. Shtimi natyror dhe bilanci i migrimeve në Vushtrri 2011-2020¹⁶

¹⁵ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë> Të dhënat i përpunoi autori

¹⁶ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë>




Grafiku 7. Shtimi natyror dhe bilanci i migrimeve në Skenderaj 2011-2020¹⁷



Grafiku 8. Shtimi natyror dhe bilanci i migrimeve në Drenas 2011-2020¹⁸

¹⁷ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë>

¹⁸ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë>



Grafiku 9. Shtimi natyror dhe bilanci i migrirove në Obiliq 2011-2020¹⁹

3.2. Trendet e emigrimeve 2011-2020

Emigrimi i popullsisë nga Kosova në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Kosova gjatë gjithë shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI ishte dhe mbeti territor tipik emigruese. Shkaktaret kryesor të cilat detyruan popullsinë të emigroj ishin dhe mbeten: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkatërrimet nga luftërat si dhe situata jo e favorshme politike etj. Ekzistojnë edhe arsye tjera që ndërlidhen me emigrimin siç janë ndërtimi i sistemit bazuar ne kriteret nepotiste duke mënjanuar meritokracin dhe vlerat në ndërtimin e sistemit etj.

Ashtu siç u theksua edhe në fillim të këtij punimi, arsyeja kryesore për emigrim është pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës me gjendjen aktuale të perspektivës socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies të cilat manifestohen me shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Midis migrirove të jashtme dhe formimit të diasporës ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Në të vërtetë, pa këtë tip të migrirove nuk mund të ketë as formim të diasporës²⁰.

Sipas statistikave zyrtare të ASK-së, nga Kosova drejt vendeve të Evropës dhe atyre tej oqeanike në periudhën 1969 - 2011 kanë emigruar mbi 550,000 banorë, të cilët së bashku me pasardhësit e tyre arrijnë numrin në mbi 703,978²¹ që përbënë afër 40% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Në bazë të disa analizave anësore²² del se ky numër është edhe më i madh dhe arrin në 965,000 persona.

Komunat e marra si mostër në këtë punim karakterizohen me pjesëmarrje të lartë të numrit të popullsisë së emigruar (emigrimet e jashtme) në raport me popullsinë rezidente në komunë. Kështu Mitrovica ka 33%, Vushtrria 26%, Skenderaj 25%, Drenasi 16% dhe Obiliqi 29% të popullsisë në migracion²³. Si në rastin e Kosovës, edhe në këto komuna, bazuar në analiza anësore del se ky numër është edhe më i madh.

¹⁹ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020", Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse.

Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullsisë>

²⁰ Islami, H. (2012). "Aspekti etnik i migrirove - Shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme". Faqe 39. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë.


²¹ "Migrimi Kosovar", Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë 2014, fq 75. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

²² Deri te kjo shifër arrihet nëse i krahasojmë statistikave të popullsisë së komunave nga regjistrimi 2011 dhe regjistrimit të realizuar nga OSCE ne vitin 2008 (dallimet) ku në bashkëpunim me komunat dhe këshillat e fshatrave kishte regjistruar numrin e përgjithshëm të popullsisë ne nivel të vendbanimeve dhe komunave e ku janë përfshirë edhe personat të cilët ndodhen në botën e jashtme.

²³ "Migrimi Kosovar". Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë 2014, fq 19. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

Emigrimet, sidomos ato të jashtme, vazhduan me intensitet të konsiderueshëm edhe gjatë periudhës 2011 - 2020. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha komunat e marra në shqyrtim karakterizohen me bilanc migrues negativ (të brendshëm e të jashtëm) duke përjashtuar këtu vitin 2020 për shkak të pandemisë (gjatë kohës kur lëvizjet, sidomos ato jashtë shtetit, ishin të kufizuara) komuna e Vushtrrisë, Obiliqit dhe Mitrovicës karakterizohen me bilanc pozitiv.

Gjithashtu duhet potencohet se emigrimet e jashtme janë formë dominuese e emigrimeve në këto komuna duke përbërë: në Mitrovicë 93%, në Vushtrri 96%, në Skenderaj 43%, Drenas 72% dhe Obiliq 98% të bilancit të migrameve. Vetëm në komunën e Skenderajt bilanci i migrameve të brendshme është më i lartë se ia atyre të jashtme.



Grafiku 10. Bilanci i migrameve në komunat e përzgjedhura 2011-2020²⁴

Nga të dhënat e prezantuara mund të konstatohet se Kosova, por edhe shumica e komunave të saj, duke përfshirë edhe komunat e përzgjedhura karakterizohen me numër të madh të diasporës e cila mund të jetë faktor shumë i rëndësishëm për zhvillim, si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional nëse mbështetet me politika të mirëfillta bashkëpunimi të cilat fatkeqësisht Kosovës i mungojnë.

3.3. Emigrimet dhe ndikimi i tyre në sistemin arsimor

Në tri dekadat e fundit, Kosova karakterizohet si territor me ulje të shpejtë të lindshmërisë dhe shtimit natyror normë të lartë të emigrimeve e përcjellë kjo me ndryshime edhe në strukturën e popullsisë sipas moshës të cilat për pasojë kanë zvogëlimin e kontingjenteve të moshave shkollore sidomos në dekadën e fundit. Zhvillimet demografike janë aq të pafavorshme sa që mund të përcaktohet edhe si krizë demografike.

Si pasoja më të rënda të krizës demografike llogariten: pasojat në trendin e fuqisë punëtore apo tregun e punës, sistemin e mbrojtjes sociale, sistemin shëndetësor, etj. Në realitet norma e ulët e lindshmërisë dhe emigrimet në periudha afatgjate më së tepërmi godasin kontingjentet e popullsisë të moshave shkollore.

Parashikimet e dinamikës së popullsisë së Kosovës në dekadat e ardhshme tregojnë se sistemi arsimor do të përballlet me sfida serioze të shkaktuara nga tendencat e pafavorshme demografike, të cilat mund të ndikojnë veçanërisht në disponueshmërinë dhe cilësinë e arsimit, fenomene të

²⁴ Vlerësim: Popullsia e Kosovës, për vitet 2011-2020”, Agjencia e Statistikave të Kosovës, vitet përkatëse. Të qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/vleresimi-i-popullise>

cilat sot kanë goditur zonat kodrinore – malore, ndërsa në të ardhmen pritet të rriten me zgjerimin e krizës demografike dhe procesit të moshimit të popullsisë²⁵.

Për sistemin arsimor pjesa më e rëndësishme janë kontingjentet e moshave shkollore, prandaj me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë në sistemin arsimor është e domosdoshme siguri i qëndrueshmërisë demografike.

Pasojat në sistemin arsimor

Sistemi arsimor është sektori i parë ku ndihen efektet e trendeve negative demografike përmes zvogëlimit të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit. Në komunën e Mitrovicës, në periudhën 2008 - 2021, numri i nxënësve është zvogëluar për 3,964 nxënës ose për -20.4%. Mitrovica në këtë periudhë ka humbur më tepër se 1/5 e numrit të nxënësve. Kështu, Mitrovica në vitin 2021 kishte 209 paraleleve më pak se në vitin 2008 (19 nxënës për paralele).

Në komunën e Vushtrrisë, në të njëjtën periudhë, numri i nxënësve është zvogëluar për 4,596 nxënës ose për -25.8%. Vushtrria në këtë periudhë ka humbur më tepër se ¼ e numrit të nxënësve. Në raport me vitin 2008, në vitin 2021 kishte 242 paraleleve më pak.

Në komunën e Skenderajt, numri i nxënësve është zvogëluar për 5,429 nxënës ose për -37.3%. Skenderaj në këtë periudhë ka humbur më tepër se 1/3 e numrit të nxënësve. Në raport me vitin 2008, në vitin 2021 kishte 286 paraleleve më pak.

Komuna e Drenasit, në periudhën 2008 - 2021, ka humbur 4,163 ose -26.3% të numrit të nxënësve (më tepër se 1/4 e numrit të nxënësve). Kështu, Drenasi në vitin 2021 kishte 219 paraleleve më pak se në vitin 2008. Në të njëjtën periudhë, komuna e Obiliqit ka humbur 1,005 ose -20% të numrit të nxënësve (1/5 e numrit të nxënësve). Kështu, Obiliqi në vitin 2021 kishte 53 paraleleve më pak se në vitin 2008. Statistika edhe me shqetësuese janë ato të numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e parë ku rënia është edhe më e madhe.

Se ky fenomen ka marr përmasa shqetësuese e argumenton edhe fakti se rreth 90% e komunave të Kosovës ballafaqohen me zvogëlim të numrit të nxënësve, zvogëlim i cili lëviz nga 10% deri në përgjysmim të numrit të nxënësve. Perspektiva e zhvillimit të ardhshëm e bënë të domosdoshme ndërmarrjen e masave në drejtim të vënies nën kontroll të fenomeneve demografike, sidomos të lindshmërisë dhe emigrimeve, pasi që parashikimet tregojnë se edhe në të ardhmen zvogëlimi i kontingjenteve të moshave shkollore do të jetë edhe më i shpejtë si pasojë e drejtpërdrejt e zhvillimeve demografike.

Nëse zhvillimit demografik nuk i kushtohet vëmendje e duhur me masa të menjëhershme përmes politikave të mirëfillta të popullatave, atëherë nga dekada e tretë e shekullit XXI, zhvillimi demografik do të shndërrohet në faktor kufizues për zhvillim në të gjitha sferat duke përfshirë edhe sistemin arsimor.

3.4. Emigrimet dhe varfëria

Edhe pse struktura e shpenzimit të remitencave në Kosovë mbetet shumë e pafavorshme sa i përket zhvillimit ekonomik, ato luajnë rol të rëndësishëm në stabilitetin social duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e varfërisë, duke i shndërruar remitencat në element të rëndësishëm në arritjen e OZhQ-ve. Këtë më se miri e ilustron fakti i hulumtimeve e fundit të opinionit publik ku 84.2% e të anketuarve besojnë se situata financiare e familjeve në Kosovë do të përkeqësohet nëse nuk do të dërgoheshin mjete në Kosovë nga diaspora (35.6% vlerësojnë se ky përkeqësim do të ishte shumë i madh)²⁶.

Ashtu siç u cek më parë, çështjet ekonomike që lidhen me papunësinë dhe varfërinë janë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Kosovës. Hulumtimet e fundit të opinionit tregojnë se këtë dy parametra ekonomike janë edhe kërcënime të sigurisë kombëtare me të cilat përballlet Kosova.

²⁵ Behrami S., Bajraktari F. "Sfidat në zhvillimet demografike të Kosovës dhe ndikimi i tyre në sistemin arsimor". Instituti Pedagogjik i Kosovës & CARITAS. Konferenca shkencore ndërkombëtare "Cilësia e arsimit para universitar në Kosovë dhe kahet e zhvillimit". Prishtinë 2021, faqe 181-194.

²⁶ "Remitancat në Kosovë- shuma të mëdha, diskutim i vogël". Organizata GERMIN, mars 2022. Fq 10.

Sipas këtyre të dhënave rreth 70% e të anketuarve besonin se shkalla e lartë e papunësisë është kërcënimi më i madh për Kosovën²⁷.

3.5. Emigrimet dhe urbanizimi

Urbanizimi është proces historik, kompleks dhe botëror i cili zhvillohet krahas me zhvillimin dhe ndryshimet e përgjithshëm shoqëror-ekonomik. Si proces kompleks urbanizimi është objekt i studimit shumë disiplinave shkencore prandaj edhe definicioni i tij varet nga aspekti i qasjes. Kështu nga *aspekti demografik urbanizimi nënkuptohet si procesi i koncentrimit të popullsisë në qytete (zona urbane)*, nga aspekti urban fjala është për koncentrimin të funksioneve në një vendbanim, ekonomistet me urbanizëm nënkupton koncentrimin e fuqisë prodhuese në industri dhe veprimtaritë posindustriale, kurse nga aspekti sociologjik urbanizimi është proces i nivelit të zhvillimit shoqëror i cili përcjellët me ndryshime në mënyrën e jetës.

Vendet por edhe komunat e zhvilluara karakterizohen me shkallë të lart të urbanizimit, ndërsa vendet dhe komunat në zhvillim kanë shkallë të ulët të urbanizimit por karakterizohen me dinamika të shpejt të këtij procesi.

Raporti midis popullsisë rurale dhe asaj urbane është indikator i rëndësishëm i nivelit të zhvillimit ekonomik e social dhe i ndarjes shoqërore të punës, si dhe i strukturës së popullsisë, intensitetit të procesit të deagrarizimit, deruralizimit dhe urbanizimit.

Fenomeni i migrimit të brendshëm në radhë të parë është i orientuar nga vendbanimet rurale drejt atyre urbane i ndikuar nga një varg faktorësh, por që dominan janë ata të natyrës socio-ekonomike siç janë: mundësitë më të mëdha për gjetjen e një vendi punë, pagës më të mire, arsim dhe shërbim shëndetësor me cilësor etj.

Këto lëvizje në njërin anë sjellim përqendrim të popullsisë në disa zona, ndërsa në anën tjetër shpopullim të zonave tjera. Zonat të cilat karakterizohen me përqendrim të popullsisë shpesh here përballen me probleme:

- ekonomike që kanë të bëjnë me: papunësinë e lart në vendbanimet urbane, e cila përcjellët me rritjen e varfërisë, dhunës, kriminalitetit, ekonomia jo formale etj.
- sociale siç janë: ngarkesa e madhe të gjitha institucioneve në vendbanimet urbane (shkollave, shtëpive të shëndetit, kopshteve etj) dhe braktisja e atyre në fshatra.
- ekologjike që kanë të bëjnë me: shkalla e lart të ndotjes së parametrave mjedisor (ajrit, ujit, tokës) zhurma, problemet me mbeturina të ngurta urbane, numri i madh i automobilave etj.
- infrastrukturë siç janë: ndërtimet dhe mbindërtimet pa plan, zbrazja e fshatrave të tëra (sidomos territoret kodrinore- malore), ngarkesa e infrastrukturës urbane, problemet në furnizim me ujë të pijshëm, ngarkesa e rrjetit të rrugëve urbane etj.

Në anën tjetër zonat me rënie demografike- shpopullimit, janë një problem shqetësues për qëndrueshmërinë e çdo vendi për disa arsye:

- shpopullimi vë në rrezik dhe pikëpyetje qëndrueshmërinë e shtetit social meqenëse përgjithësisht ulja e popullsisë përkthehet në rritje të moshës mesatare, vjetërsim, çka nënkupton rritje të shpenzimeve publike për pensione dhe shëndetësi.
- shpopullimi shoqërohet me frenim të rritjes ekonomike, sepse ai përcillet me largimin e të rinjve të cilët potencialisht janë bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik, social, politik të zonës²⁸.

²⁷ Behrami S. (2019). "Emigrimet! A po rrezikohet Kosova nga ky fenomen?". Kosova Sot. E qasshme në: <https://www.kosova-sot.info/opinione/431875/emigrimet-a-po-rrezikohet-kosova-nga-ky-fenomen/> (e qasur në gusht 2022)

²⁸ Maestas, N., Mullen, K., & Powell, D. (2016). The Effect of Population Aging on Economic Growth, the Labor Force and Productivity. NBER Working Paper No. 22452.

- shpopullimi është në qendrën e një cikli vicioz të rënies ekonomike, meqenëse papunësia e lartë krahas problemeve sociale, sigurisë dhe kriminalitetit është një faktor përcaktues për largimin e të rinjve dhe njerëzve të aftë, gjë e cila varfëron akoma më tej tregun lokal të punës, i cili kështu gjendet brenda një spirale rënëse²⁹.

Shpopullimi i zonave të ndryshme në Kosovë (sidomos i zonave rurale dhe kodrinore- malore) është përcjell me reduktimi i disa shërbimeve publike duke sjellë përkeqësim te cilësisë të jetës për popullsinë, e cila në kërkim të kushteve më të mira vendos të largohet. Për më tej ky reduktim i popullsisë nuk justifikon praninë e disa shërbimeve publike të tjera (shkolla, ambulanca etj), të cilat reduktohen akoma më shumë duke ngecur sistemin në një lloj rrethi vicioz.

Depopullimi i më tejme i këtyre zonave do të përcillej me pasoja të shumta të natyrës demografike, në radhë të parë me moshimin e popullsisë, që do të pamundësonte:

- ❖ rivitalizimin demografik dhe ekonomik të zonës
- ❖ do të krijonte zona të cilat nuk mund ta ripërtrijn veten (popullsia) dhe jetën ekonomike dhe
- ❖ do të pamundësonte zhvillimin e qëndrueshëm: demografik i cili do të përcillej me pa qëndrueshmëri ekonomike dhe mjedisore.

Në të njëjtën kohë imtësimi i vendbanimeve paraqet problem e ne disa raste edhe pamundëson ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për jetë në këto vise.

Për zgjidhjen e këtyre problemeve është e nevojshme përgatitja e planeve të mirëfillta zhvillimore dhe urbane të komunave dhe zonave brenda për brenda komunave si dhe përgatitja e një Strategjie të Zhvillimit të Urbanizimit në Kosovë. Përndryshe, të dyja rastet nëse nuk përgatiten plane dhe strategji të mirëfillta mund të paraqiten si pengës për investime nga diaspora si ne nivel lokal edhe atë qendror dhe do të vështirosjen rrugën e komunave dhe Kosovës si tersi drejt përmbushjes së OZHQ.


4. Roli i nivelit lokal në fuqizimin e emigrantëve

4.1. Fuqizimi i emigrantëve

Fuqizimi i komuniteteve të emigrantëve u lejon atyre të maksimizojnë angazhim e tyre në zhvillim lokal që do të përcillet me rezultate pozitive në shumë segmente të zhvillimit në nivel lokal. Autoritetet lokale kanë rol kyç në lehtësimin e krijimit të raporteve të qëndrueshme me komunitetin e emigrantëve, sidomos me fuqizimin e tyre.

E qasshme në: https://www.nber.org/system/files/working_papers/w22452/w22452.pdf

²⁹ Šerý, O., Svobodová, H., Šilhan, Z., & Szczyrba, Z. (2017). Shrinking of Cities in the Czech Republic and its Reflection on Society: Case Study of Karviná City. *Geographica Pannonica* 22. E qasshme në: https://www.researchgate.net/publication/323362224_Shrinking_of_Cities_in_the_Czech_Republic_and_its_Reflection_on_Society_Case_Study_of_Karvina_City



Grafiku 11. Fuqizimi i diasporës

Gjithashtu, autoritetet lokale mund të ndikojnë në fuqizimin e diasporës edhe përmes:

- përmirësimit të mjeteve të komunikimit në mes anëtarëve të komunitetit dhe emigrantëve për të ndërvepruar me emigrantët e tjerë;
- mbështetjes dhe organizimit të takimeve të drejtpërdrejta në mes anëtarëve të komunitetit dhe emigrantëve të grupeve të ndryshme të interesit;
- të nxisë partneritete ndërmjet autoriteteve lokale për t'u angazhuar në projekte, shkëmbim të njohurive dhe zhvillim të skemave fillestare të projekteve të përbashkëta;
- mbështetje dhe fuqizim në krijimin e organizatave të cilat promovojnë dhe angazhohen në sferën emigrim - zhvillim, rrjetet ndërkombëtare të shoqatave profesionale;
- thellimin e bashkëpunimit me vendet ose regjionet të caktuara të vendeve të destinacionit ku ka koncentrim më të madh të emigrantëve, etj.

Me qëllim të arritjes së këtyre objektivave autoritetet lokale duhet të ngrisin dhe mbështesin kapacitetet e tyre, si dhe të mobilizohen dhe të jenë të gatshme për mbështetje dhe krijimin e hapësirës së mjaftueshme të diasporës, organizimeve profesionale nga diaspora dhe bashkëpunimit më të mirë me komunitetin e emigrantëve në të gjitha sferat e jetës, posaçërisht me ato të karakterit zhvillimor³⁰.


4.2. Roli i vetëqeverisjes lokale në fushën e migrimeve dhe zhvillimit në Kosovë

Kompetencat e vetëqeverisjes lokale janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale përcakton fuqinë e plotë të autoriteteve lokale për sa i përket interesave lokale. Ky ligj, po ashtu, përcakton qartësisht kompetencat mbi organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, financimin e komunave, marrëdhëniet brenda komunave, bashkëpunimin ndër-komunal dhe me institucionet e nivelit qendror. Komunitet kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ofrimin e përkujdesjes kujdesit shëndetësor primar;
- shëndetësinë publike;
- turizmin;

³⁰ Introductory module on migration and local development, Joint Migration and development Initiative (JMIDI), fq. 81, E qasshme: <https://returnandintegration.iom.int/en/learning/e-courses/my-jm-di-e-toolbox-migration-and-local-development>

- r) aktivitetet kulturore dhe të lira;
 s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër³¹.



Grafiku 12. Dimensionet e zhvillimit lokal

Siç shihet, niveli lokal mbështetur në legjislacionin në fuqi ka kompetenca të gjera në shumë fusha të cilat i mundësojnë bashkëpunim me mërgatën. Këtë ja mundësojnë edhe parimet themelore të financave komunale, ku theksohet (neni 24):

- Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake; granateve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; *donacioneve dhe të hyrave të tjera* të rregulluara këto edhe me Ligjin për financat lokale.

Njësia e vetëqeverisjes lokale përmes njësisë për zhvillim ekonomik lokal dhe mbështetje për investime mund të përdorin instrumente të politikave zhvillimore vendore për të nxitur tërheqjen e investimeve, kujdesin për investimet ekzistuese dhe zgjerimin e tyre, numrin dhe vlerën totale të investimeve dhe cilësinë e investitorëve, zbaton standardet e një mjedisi të favorshëm biznesi dhe merr vendime për masat për nxitjen e konkurrencës së vetëqeverisjes vendore në tërheqjen e investimeve.

Me qëllim të rritjes së konkurrencës, komunat duhet të ndërmarrin disa masa si në vijim:

- 1) përcaktimin e organeve të cilat do të mbështesin investimet;
- 2) forcimin e bazës dhe krijimin e politikave zhvillimore, instrumenteve dhe masave zhvillimore në fushën e zhvillimit ekonomik lokal;
- 3) krijimin e mekanizmave transparent të komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me akterët e zhvillimit lokal;
- 4) thjeshtësimin e procedurave lokale për realizimin e investimeve (mënjanimi i burokracive);
- 5) balancimin e tregut lokal të punës;
- 6) zhvillimin e infrastrukturës ekonomike komunale dhe lokale;
- 7) përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të arritur komunikim;
- 8) përfshirja e lehtësirave në dokumentet strategjike lokale, etj.

Veprimtaria e njësisë për zhvillim ekonomik vendor dhe mbështetja për investime në komunat e Kosovës kryhet nga drejtoritë përgjegjëse, mirëpo mund të kryhen edhe nga institucione të specializuara të nivelit komunal ose regjional, shoqata të ndryshme, personat fizikë nga radhët e punonjësve ose personat të cilët kanë njohuri dhe përvojë për ofrimin e ndihmës profesionale tek investitori të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore i angazhojnë për kryerjen e atyre detyrave. Gjithashtu, edhe dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të caktojnë bashkërisht

³¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

një organ të cilit i besohet puna në mbështetje të investimeve për territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

4.3. Përfshirja e potencialit migrues në dokumentet strategjike komunale - gjendja në komunat Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas dhe Obiliq

Shqyrtimi i dokumenteve strategjike, qoftë të nivelit qendror e posaçërisht të nivelit lokal, tregojnë sesa pak institucionet qendrore e sidomos ato lokale e njohin potencialin e mërgatës për zhvillim të përgjithshëm dhe lokal.

Gjithashtu, duhet nënvizuar se dokumentet strategjike zhvillimore komunale në shumicën e rasteve përgatiten me kapacitete të kufizuara humane dhe intelektuale dhe më tepër si obligime ligjore, prandaj shpesh herë më tepër i dezorientojë sesa i orientojnë komunat drejt zhvillimit ekonomik lokal.

Një shembull konkret i përgatitjes joprofesionale - rasti i Plani Zhvillimor Komunal të Mitrovicës Jugore 2019 - 2027

Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik i cili kërkon qasje dhe trajtim multidisiplinar. Meqenëse kemi të bëjmë me parashikime zhvillimore, është e kuptueshme se këtu kemi të bëjmë me parashikime në shumë fusha për periudhën e dhënë ku rolin dominant e kanë parashikimet e popullsisë nga saktësia e të cilave varet edhe parashikimi i të gjitha fushave tjera të cilat trajtohen në Planin Zhvillimor Komunal.

1. Skenarët e popullsisë: në të tri rastet joprofesionale.

Sipas ASK në fillim të vitit 2020, Mitrovica kishte 68,840 banorë (zvogëlim të banorëve në raport me 2011). Sipas skenarit realist të përgatitur nga hartuesi në vitin 2021, Mitrovica do të ketë 99,593 banorë, rritje e cila nuk mund të shpjegohet nga këndvështrimi demografik kur shqyrtohen trendet e shtimit natyror dhe bilancit të migrimeve në periudhën 2011 - 2020.

2. Sipas të njëjtit skenar popullsia urbane do të arrijë në 77,111 banorë, ndërsa në tabelën e vendbanimeve zona urbane e Mitrovicës ka 46,568 banorë (shifra e popullsisë urbane nuk arrihet edhe me shtimin e popullsisë së vendbanimeve periferike³² .

Raste të tilla janë të shumta edhe në dokumentet tjera strategjike të komunave të tjera të cilat më tepër i dezorientojë sesa i orientojnë komunat drejt zhvillimit ekonomik lokal.

4.4. Niveli lokal/komunal

Nga dokumentet strategjike të elaboruara të nivelit lokal (10 dokumente strategjike: 4 të komunës së Mitrovicës, 1 të komunës së Vushtrrisë, 1 të komunës së Skenderajt, 2 të komunës së Drenasit dhe 2 të komunës së Obiliqit), respektivisht Plane zhvillimore komunale dhe Strategji të zhvillimit ekonomik lokal mund të konstatohet se pushteti lokal në Kosovë nuk ka njohuri dhe vizion në lidhje me rolin dhe rëndësinë e migrimeve për zhvillimin ekonomik lokal.

	Nr. i faqeve	Përmendja e diasporës	Sponzorizues
Plani zhvillimor komunal 2020-2028	95	0	Komuna e Mitrovicës Jugore
Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) Mitrovica 2009 - 2025+	253	2	Kuvendi Komunal Mitrovicë
Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) Mitrovica Jugore 2019-2027	241	1	Komuna e Mitrovicës Jugore
Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Mitrovicën 2014 - 2017	52	0	Komuna e Mitrovicës

³² Një nga sugjerimet e autorit të deponuara në Komunën e Mitrovicës pas debatit publik me qytetar për përpiluesin, Drejtorin e Urbanizmit dhe Kryetarin e Komunës së Mitrovicës.

Plani zhvillimor komunal i Vushtrrisë 2016-2024	221	1	Komuna e Vushtrrisë
Plani zhvillimor komunal i Skenderajt 2017-2025	120	1	Komuna e Skenderajt
Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit (Draft) 2020-2028	181	1	Komuna e Glllogocit
Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024	61	0	Komuna e Glllogocit
Profili i Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028	88	1	Komuna e Obiliqit
Strategjia për zhvillim socio-ekonomik lokal 2017-2021	96	0	Komuna e Obiliqit

Tabela 1. Dokumentet e elaboruara në hulumtim (niveli lokal)

Në katër dokumentet strategjike zhvillimore të komunës së Mitrovicës, përveç faktit që diaspora nuk trajtohet si potencial zhvillimor, shqetësuese është fakti se në 641 faqe (të gjitha dokumentet) diaspora përmendet vetëm 3 herë edhe atë në pjesët ku trajtohen çështjet në nivel të vendit.

Gjendja është e njëjtë edhe në dokumentet strategjike zhvillimore të komunave tjera (Tabela 1), që më së miri e shpjegon faktin sesa pak institucionet lokale kanë njohuri dhe e trajtojnë diasporën si potencial zhvillimor. Kjo e bën të domosdoshme dhe urgjente sensibilizimin dhe trajnimin e institucioneve lokale me qëllim të shndërrimit të diasporës në potencial zhvillimor komunal.

4.5. Niveli qendror

Gjendja sa i përket përfshirjes së diasporës në zhvillim ekonomik të vendit nuk është më e mirë as në dokumentet strategjike të nivelit të vendit. Tri dokumentet më të rëndësishme të nivelit qendror të cilat rregullojnë zhvillimin ekonomik lokal janë:

1. Strategjia për Zhvillim Rajonal për periudhën 2020 – 2030 ka tri objektiva strategjike: (1) Koordinimi i politikave të zhvillimit rajonal; (2) Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër-rajonale dhe (3) Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.

Në këtë dokument, në kuadër të potencialit zhvillimor në asnjë rast diaspora nuk llogaritet si potencial zhvillimor. Se diaspora është anashkaluar plotësisht në këtë strategji mjafton të përmendet fakti se në materialin 59 faqes, diaspora përmendet vetëm një herë (fq 36) edhe atë "Shfrytëzimi i njohurive të diasporës për zhvillim të rajoneve" dhe një herë emigrimet e popullsisë si rrezik (fq33) . Kjo nënkupton sesa pak institucionet qendrore e njohin potencialin e mërgatës për zhvillim të përgjithshëm dhe lokal.

	Nr. i faqeve	Sponzorizues
Strategjia për Zhvillim Rajonal për periudhën 2020-2030	59	Ministria për Zhvillim Rajonal
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023	44	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026	75	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Strategjisë Zhvillimore të Kosovës 2030	186	Qeveria e Kosovës
Strategjia e Diasporës 2020-2024 (Draft)		Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
Strategjia për Migrim 2021-2025	44	Ministria e Punëve të Brendshme

Tabela 2. Dokumentat e elaboruara në hulumtim (niveli qendror)

2. *Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019 - 2023* paraqet një dokument strategjik të bazuar në planin e veprimit që ka për synim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim ekonomik lokal.

Strategjia ka katër objektiva strategjike të cilat janë: (1) Rritja e qëndrueshmërisë financiare e komunave; (2) Tërheqja e investimeve të huaja; (3) Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor dhe (4) Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Sikurse edhe në dokumentin paraprak potenciali i diasporës nuk llogaritet si potencial zhvillimor. Në materialin 44 faqesh, diaspora nuk përmendet as edhe një herë duke përfshirë këtu edhe Objektiva strategjike nr. 2: Tërheqja e investimeve të huaja.

3. *Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026*, objektiva e parë e të cilës (nga gjithsej 5) e kësaj strategjie është fuqizimin e rolit të komunave si akterë kryesorë në zhvillimin ekonomik lokal. Sikurse edhe në dokumentin paraprak potenciali i diasporës nuk llogaritet si potencial zhvillimor. Në materialin 75 faqesh, diaspora nuk përmendet as edhe një herë në dokument.

Edhe pse në grupin punues të formuar për përgatitjen e strategjisë ishin përfshirë 21 institucione të ndryshme, aty mungojnë akterët kryesorë duke përfshirë këtu: Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (e cila ishte funksionale në këtë periudhë), Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe institucionet shkencore.

Dy dokumentet më të rëndësishme të nivelit kombëtar në të cilat do të duhej të përfshihet komponenta e zhvillimit të ndërlidhur me migrimin karakterizohen me mangësi të shumta. Një ndër mangësitë kryesore të *Strategjisë Zhvillimore të Kosovës*, si dokument strategjik kryesor në fushën e zhvillimit, lidhet me faktin se e neglizhon tërësisht migracionin si një mjet zhvillimi. Në të njëjtën frymë, *Strategjia e Diasporës* fokusohet kryesisht në përfshirjen sociale, politike dhe kulturore të diasporës dhe nuk ofron politika të cilat do të inkurajonin një angazhim më të madh të diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Ky dokument në radhë të parë ka për qëllim ruajtjen e lidhjeve në mes të diasporës dhe Kosovës. Si i tillë, fokusohet kryesisht në përfshirjen sociale, politike dhe kulturore të diasporës duke mos ofruar platformën për kontributin e diasporës në zhvillimin ekonomik të Kosovës duke marrë për bazë remitencat dhe kontributin në Investimet e Huaja Direkte (IHD)³³, edhe pse një nga objektivat strategjike është roli i diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.

Strategjia për Migrim 2021 - 2025 është orientuar në drejtim të bërjes së migrimit të rregullt dhe të sigurtë dhe si i tillë ka një qasje zhvillimore. Në këtë drejtim, janë paraparë masa për të ndërlidhur tutje migrimin dhe zhvillimin me fokus në shfrytëzimin e potencialit të diasporës për qëllim të zhvillimit ekonomik, përmes lehtësimit të transferimit të remitencave, promovimit të investimeve, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe angazhimit të eksperteve nga diaspora (kthimi i dijes). Po ashtu, janë paraparë masa të cilat konsistojnë në zhvillimin e politikave dhe skemave që synojnë menaxhimin e migrimit për qëllime të punësimit dhe konsolidimin e sistemit të mobilitetit të migrantëve³⁴.

Aktualisht, Kosova disponon disa politika të lidhura me migrimin dhe diasporën, por ato politika janë të fragmentuara dhe nuk kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë politikat strategjike aktuale dhe të zhvillojë një dokument të ri strategjik bazuar në konceptin e migrimit dhe zhvillimin me synim që të maksimizojë potencialin e diasporës në rritjen ekonomike të Kosovës³⁵. Rol të rëndësishëm në përgatitjen e dokumenteve strategjike zhvillimore, si në nivel lokal ashtu edhe atë kombëtar, duhet të kenë ekspertët dhe institucionet akademike.

Me këtë rast institucionet e nivelit qendror, por edhe ato të nivelit lokal, me qëllim të përmbushjes me sukses të përfshirjes së potencialit migrues në dokumentet strategjike duhet të kenë parasysh përmbushjen e tri objektiva kryesore.

³³ "Kosova: Trendet e migracionit kërkojnë një qasje të re strategjike". Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) Shtator 2020. fq 39

³⁴ *Strategjia për Migrim 2021-2025*. Ministria e Punëve të Brendshme, fq 20

³⁵ "Kosova: Trendet e migracionit kërkojnë një qasje të re strategjike". Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) Shtator 2020. fq 34.

Së pari, autoritetet vendore duhet të integrojnë migrimin dhe diasporën në dinamikën, planifikimin dhe dokumentet strategjike zhvillimore. Kjo për faktin se migrimet janë çështje ndër-sektoriale dhe me ndikim në shumë sektorë (ekonomi, shëndetësi, arsim, etj.) duke ndikuar edhe në plotësimin e shumë OZhQ. Për këtë arsye, institucionet e të dy niveleve të qeverisjes duhet të ndër marrin masa me qëllim të forcimit të menaxhimit të migracionit dhe të rritjes së ndikimit në zhvillim.

Së dyti, autoritetet lokale duhet të nxisin dhe të promovojnë lidhjet me territorin e destinacionit të emigrantëve duke shfrytëzuar emigrantët si një urë lidhëse mes të dyja territoreve, siç është rasti i binjakëzimit të komunave ose bashkëpunimit me shoqatat profesionale në diasporë, sidomos me profesionet deficitare në sferën e biznesit dhe shëndetësisë (përmes vizitave studimore dhe transferimit të njohurive). Për thellimin e këtij bashkëpunim është e domosdoshme një shkallë më e lartë e decentralizimit të kompetencave në fushën e emigracionit dhe zhvillimit.

Dhe së treti, autoritetet lokale dhe kombëtare duhet të koordinohen në përgatitjen e programeve dhe dokumenteve strategjike me qëllim të krijimit të hapësirave dhe mundësive për investime të diasporës në vendlindje, duke:

- ju mundësuar emigrantëve të shprehin potencialin e tyre;
- ju krijuar një mjedis të favorshëm që do të mundësojë integrimin e emigracionit në politikat e zhvillimit lokal;
- ju krijuar një realitet të ri shoqëror në konsistencë dhe koherencë me politikat kombëtare të migracionit, disponueshmërinë e shërbimeve gjithëpërfshirëse në funksion të zhvillimit, sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë, etj.

5. Roli i autoriteteve lokale në integrimin e diasporës

5.1. Krijimi i kushteve për rintegrim të suksesshëm

Është thelbësore që autoritetet lokale të krijojnë një mjedis të favorshëm dhe gjithëpërfshirës duke u ofruar emigrantëve hapësirë që t'ju dëgjohen mendimet dhe idetë e tyre, të krijohen korniza për rritjen e besimit midis pushtetit lokal dhe emigrantëve, pushtetit lokal dhe shoqatave të emigrantëve, etj.

Disa nga faktorë të cilët ndikojnë në integrimin në mënyrë efikase të emigracionit në zhvillimin lokal është edhe aftësia e autoriteteve lokale në përmirësimin e kushteve për integrim, i cili kërkon ndërmarrjen e disa hapave.

Së pari, niveli i decentralizimit ka rëndësi pasi ai ndikon drejtpërdrejt në kompetencat e autoriteteve lokale në bashkëpunim me emigracionin, e rëndësishme kjo për vendimin dhe zbatimin e tyre në nivel lokal. Ndonëse nuk është një parakusht për ngritjen e mekanizmeve të integrit, decentralizimi shton vlerë pasi lejon një pjesëmarrje më të zgjeruar të të gjithë akterëve lokalë, që do të thotë se përpjekjet për hartimin dhe zbatimin e politikave u përgjigjen më saktë nevojave lokale.

Së dyti, pavarësisht nivelit të decentralizimit, mekanizmat e dialogut që ekzistojnë ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe lokale janë kyçe për krijimin e politikave adekuate që janë në përputhje me prioritetet kombëtare dhe realitetet lokale të cilat kërkojnë koherencë midis politikave kombëtare dhe lokale. Me këtë rast, në nivel lokal duhet krijuar qendra këshilluese për emigrim dhe zhvillim duke ndarë buxhet dhe personel përkatës për të udhëhequr aktivitetet në funksion të shfrytëzimit të potencialit të emigrantëve për zhvillim lokal në secilën komunë. E gjithë kjo është e domosdoshme të përcillet me përfshirjen e migracionit në planifikimin e zhvillimit lokal, rajonal dhe kombëtar.

Së treti, zbatimi i Agjendës 2030, në të cilën migrimi përfshihet përmes objektivave specifike, paraqet një mundësi unike për të rritur rolin e autoriteteve lokale në menaxhimin e migracionit në lidhje me zhvillimin. Kjo gjithashtu mundësohet dhe është e përfshirë edhe në Agjendën Lokale të Kuitos, e mbështetur nga Iniciativa e Përbashkët e Kombeve të Bashkuara për Migracionin dhe

Zhvillimin (JMDI)³⁶. Për më tepër, edhe Agjenda e Re Urbane, migracionin dhe menaxhimin e migracionit e trajton si komponentë kyçe për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Të gjitha këto i shndërrojnë migrimet në element të rëndësishëm në plotësimin e shumë (rreth 60%) të OZhQ-ve. Kjo është edhe arsyeja që institucionet lokale domosdoshmërisht duhet të krijojnë kushte për integrim të suksesshëm të migrirove në politikat zhvillimore lokale, meqenëse autoritetet lokale kanë një rol shumë të rëndësishëm në përmbushjen e OZhQ-ve dhe Agjendës 2030.

5.2. Mundësitë e bashkëpunimit me diasporën dhe shfrytëzimi i potencialit për zhvillim lokal

Nga praktika e përditshme mund të konstatohet se interesi i diasporës për investim është shumë më i madh në investimet në nivel lokal (vendlindje dhe komunën e lindjes) sesa në nivel qendror, e kushtëzuar kjo nga shumë faktorë, që do të thotë se edhe në rastet kur pjesëtarët e diasporës vendosin të investojnë në vendin e tyre, në shumicën e rasteve bëhet fjalë për investim në vendlindjen e tyre. Nga numri i përgjithshëm i investimeve nga diaspora, rreth 90% i referohet investimeve në vendlindje apo rajon. Këto të dhëna na tregojnë për mundësitë e mëdha që ka niveli i pushtetit lokal në dispozicion për zhvillim mbështetur në potencialin investues nga diaspora. Gjithashtu, diaspora investon në fuqi punëtore të re dhe të kualifikuar, organizimin e trajnimeve për punonjësit dhe pajisjen e kompanisë me pajisje moderne. Pushtetet vendore mund të inkurajojnë më tej investimet në infrastrukturë duke ofruar partneritete publiko-private dhe forma të tjera të bashkëpunimit për investitorët e diasporës. Krahas investimeve, motivi i diasporës nuk është gjithmonë fitimi, por edhe dëshira për të kontribuar në zhvillimin e atdheut që lidhet me motive të karakterit emocional, veprimet humanitare, etj.

Rëndësia e investitorëve të diasporës është se ata kanë potencial të madh për të lobuar në kompanitë e huaja për të investuar në Kosovë, rajon apo në nivel lokal. Anëtarët e diasporës shpesh organizojnë ngjarje të destinuara për përfaqësues të sektorëve dhe degëve të caktuara ekonomike nga vendi amë dhe nga vendi pritës, gjë që kontribuon në binjakëzimin dhe promovimin e ekonomisë vendase në tregun ndërkombëtar.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është domosdoshmëria që pushtetet vendore (qendror apo lokal) duhet ta njohin dhe promovojnë diasporën si partner të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal dhe më gjerë për zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe një burim të rëndësishëm për financimin e projekteve strategjike të të gjitha niveleve.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh zhvillimin e pamjaftueshëm të kapaciteteve në nivel lokal për bashkëpunim me diasporën, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për bashkëpunim me diasporën ose besimin e kësaj kompetence tek ato ekzistuese, është e domosdoshme fillimi i trajnimit të punonjësve që do të merren me këtë aktivitet. Gjithashtu, është e nevojshme zhvillimi i një programi trajnues për punonjësit në njësitë e vetëqeverisjes vendore lokale e qendrore duke përfshirë një program të trajnimit të përgjegjësve për bashkëpunim me diasporën.

Në mesin e partnerëve zhvillimor, qoftë të nivelit qendror ose lokal të vendit, diaspora do të duhej të trajtohet si një ndër partnerët kryesor të zhvillimit të vendit të origjinës, sidomos në rastet kur diaspora përfaqëson rreth gjysmën e popullsisë, siç është rasti i Kosovës ose edhe 1/3 apo 1/4 siç është rasti në shumë komuna të Kosovës. Me këtë rast shfrytëzimi i praktikave të mira ndërkombëtare, të cilat nuk janë të pakta, do të ishte një mundësi që duhet shfrytëzuar si në nivel lokal dhe atë qendror. Sot qeveritë në shumë vende të botës (sidomos atyre me diasporë të madhe siç është edhe rasti i Kosovës), janë të orientuara në drejtim të avancimit të politikave mbështetëse për diasporën me qëllim të krijimit të kushteve dhe lehtësirave me qëllim të angazhimit të diasporës në zhvillimin e vendit përmes masave që kanë të bëjë me lehtësimin e transfereve të remitencave, nxitjen e investimeve në vendin e origjinës, qarkullimin e njohurive, etj.

Kontributi specifik i diasporës varet nga akterët të cilët janë përfshirë, nga forma e veprimeve të tyre, nga arsyet pse janë përfshirë në procesin e zhvillimit dhe nga natyra e aktiviteteve të tyre.

³⁶ E qasshme në: <https://oecd-development-matters.org/2017/01/10/migration-an-overlooked-tool-for-local-development/>

Dërgimi i remitencave, transferimi i aftësive dhe njohurive, investimi dhe krijimi i lidhjeve transnacionale janë mekanizmat që kontribuojnë në zhvillimin e vendit të origjinës.

Anëtarët e diasporës, në proceset zhvillimore në vendin e origjinës mund të përfshihen në mënyra të ndryshme, duke filluar nga vendi i destinacionit, në rast kthimi të përhershëm në vendin e origjinës, nëpërmjet kthimit të përkohshëm ose nëpërmjet "kthimit virtual" dhe qarkullimit të njohurive (platforma online, mentorim online, etj.) e cila sot si praktikë po gjen përdorim gjithnjë e më të madh.

Për të aktivizuar potencialin dhe për të vendosur bashkëpunimin me diasporën fillimisht është e nevojshme njohja me shpërndarjen gjeografike të diasporës dhe shoqatave ekzistuese, por edhe konsultime të gjera me pjesëtarët e diasporës para se të fillohet me forma specifike të bashkëpunimit. Në këtë aspekt Kosova ka një bazë të mirë të të dhënave për shpërndarjen e mërgatës, të dhëna dhe bashkëpunim me shoqata të shumta të mërgatës, si dhe bashkëpunim të mirë me rrjete të shumta profesionale të krijuar nga mërgata me qëllim të bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të përvojave mes anëtarëve të diasporës.


Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe rritjen e ndikimit të diasporës në zhvillimin lokal, autoritetet lokale duhet të plotësojnë disa kushte:

1. Të mobilizohen në përfshirjen e ideve të diasporës në dokumentet strategjike zhvillimore,
2. Të kërkojnë dhe t'ju japin hapësirë këshillave dhe udhëzimeve të mërgatës dhe ato të përfshihen në programe konkrete zhvillimore komunale, duke ju dhënë atyre rol të rëndësishëm zhvillimor,
3. Të nxisin konsultimet dhe marrjen e këshillave nga emigrantët në planifikimin, zbatimin dhe zhvillimin e projekteve, si dhe të rrisin pjesëmarrjen e tyre në procesin e politikbërjes përmes këshillave të ekspertëve të diasporës, përfshirjen e emigrantëve përmes përfaqësimit në trupat e nivelit lokal, etj.,
4. Të krijojnë programe për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin e emigrantëve (edhe individual) për realitetet në vendet e tyre të origjinës, projektet e vazhdueshme të zhvillimit dhe mundësitë për angazhimin e tyre,
5. Të përfshijnë komunitetet e emigrantëve në planifikimin e politikave dhe projekteve lokale si mjete shumë të rëndësishme për (ri)integrimin e tyre në vendin e origjinës që garanton rritjen e interesave të tyre, respektit dhe të drejtave të tyre,
6. Të rris pjesëmarrjen aktive të shoqatave të emigrantëve dhe komunitetet në procesin e politikbërjes, sidomos në fushat që kanë të bëjnë me migrimet dhe zhvillimin nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror, etj³⁷.

5.3. Rëndësia e remitancave dhe investimeve për zhvillimin lokal

Në Kosovë në dekadën e fundit, remitencat kanë shënuar rritje të vazhdueshme, pavarësisht krizave globale ekonomike, shëndetësore, politike, etj. Në vitin 2021 nga diaspora janë pranuar 1,143.9 miliard Euro që në raport me vitin 2008 kanë treguar rritje për 541.2 milionë Euro ose 88.9%.

³⁷ Introductory module on migration and local development, Joint Migration and development Initiative (JMDI), fq 85-86, E qasshme në: <https://returnandreintegration.iom.int/en/learning/e-courses/my-jmdi-e-toolbox-migration-and-local-development>



Grafiku 13. Remitenca në Kosovë 2008 - 2021

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, shuma totale e dërgesave financiare/remitenca në Kosovë nga diaspora që nga shpallja e pavarësisë në 2008 e deri në vitin 2021 është 9,874 miliardë Euro.

Megjithëkëtë, ky potencial ende mbetet jo sa duhet i shfrytëzuar dhe i kanalizuar në aktivitetet produktive që do të kishin efekte zinxhirore ekonomike. Gjysma e remitenca në para të gatshme janë përdorur për konsum, 18% janë përdorur për ndërtimin e shtëpive dhe për riparime, 17% për qëllime shëndetësore, 15% për arsim dhe vetëm një pjesë modeste prej 3% përdoret për investime, që tregon se vetëm një pjesë shumë e vogël e remitenca të pranuar në para të gatshme investohen në aktivitete prodhuese/ndërmarrëse (më pak se 4%)³⁸.

Sikur Kosova të tregonte performancë më të mirë në uljen e varfërisë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, atëherë remitenca nuk do kishin nevojë të shfrytëzoheshin për konsum të produkteve ushqimore, por të koncentroheshin në edukim të fëmijëve dhe investime të cilat do të gjeneronin të ardhura dhe rritje të punësimit, meqenëse edhe vet pranuesit e remitenca konsiderojnë se shpenzimi më i madh do të duhej të ishte në investime në hapjen e bizneseve (36%) dhe investime në edukim (33%)³⁹, që dallon shumë në krahasim me shpenzimin real të tyre. Kjo e bën të domosdoshëm edukimin financiar për pranuesit e remitenca, me qëllim të informimit që ato të shpenzohen në sektorë më produktiv dhe në përmirësim të mirëqenies së tyre.

Kur kësaj i shtohet edhe mungesa e politikave inkurajuese, planeve, strategjive dhe dokumenteve tjera zhvillimore, si dhe mos përfshirja e mërgatës në këto plane dhe strategji zhvillimore qoftë te nivelit qendror, qoftë te nivelit lokal, atëherë nuk ka sesi ndikimi i remitenca nga diaspora të ketë ndikim pozitiv të fuqishëm në zhvillimin ekonomik qendror dhe lokal.

Edhe pse struktura e shpenzimit të remitenca në Kosovë mbetet shumë e pafavorshme, sa i përket zhvillimit ekonomik, ato luajnë rol të rëndësishëm në stabilitetin social duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e varfërisë, duke i shndërruar remitenca në element të rëndësishëm në arritjen e OZhQ-ve. Si një burim që siguron gjendje stabile sociale, remitenca zvogëlojnë edhe ngarkesën ndaj buxhetit shtetëror.

Sikurse edhe shumë procese tjera, edhe remitenca i kanë efektet negative të cilat mund të jenë:

- rritja e pabarazive dhe krijimi i hendekut në mes zonave me pjesëmarrje të lartë të emigrantëve kundruall atyre me pjesëmarrje më të ulët (p.sh. në mes komunave, zonave urbane dhe rurale, midis vendbanimeve rurale, etj);

³⁸ "Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018", Ministria e Diasporës, Prishtinë 2014, fq 18.

³⁹ "Remitenca në Kosovë- shuma të mëdha, diskutim i vogël". Organizata GERMIN, mars Prishtinë 2022. fq 9.

- ndikimi negativ në tregu i punës duke krijuar një “kulturë varësie” (në nivel familjar, komunal dhe shtetëror), e cila çon në humbjen e stimujve për të kërkuar punë;
- shkaktimin e mundësisë së emigrimit shtesë, etj.

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se remitencat janë kapital privat që një emigrant i dërgon familjes së tij, por ato në asnjë mënyrë nuk duhet të zëvendësojnë fondet që investon shteti apo fonde të tjera.

Sfiduese për ekonominë e Kosovës vazhdon të mbetet kanalizimi i dërgesave nëpërmjet rrugëve formale, sidomos atyre bankare meqenëse ende mbi 80%⁴⁰ e dërgesave nga mërgata realizohet përmes agjencive për transferim të parave ose rrugëve tjera, transferim të cilat kanë kosto të larta. Institucioneve qeveritare në bashkëpunim me ato financiare duhet të krijojnë politika të përbashkëta në mënyrë që kosto e shërbimeve (dërgimit të remitencave nga diaspora) të jetë sa më e favorshme që do të motivonte diasporën për kontribut edhe më të madh duke shfrytëzuar rrugët formale, sidomos atyre bankare për dërgim të remitencave.

5.4. Bashkëpunimi me diasporën – udhëzimet e organeve komunale për përmirësimin e bashkëpunimit me diasporën

Për të gjitha aktivitetet në raportin zhvillim lokal - emigrim dhe krijimin e bashkëpunimit është e nevojshme që komuna të jetë proaktive me qëndrime ndaj diasporës, për të përditësuar të dhënat për emigrantët dhe për të vlerësuar se çfarë lloj bashkëpunimi dhe zhvillimi politikash mund të përdorin me qëllim të avancimit të këtij bashkëpunimi.

Në vazhdim do të paraqiten disa rekomandimet të cilat mund të ndihmojnë në gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit duke mbështetur iniciativat specifike të diasporës duke i koordinuar ato me nevojat e zhvillimit lokal përmes projekteve të përbashkëta.

5.5. Aktivitete që synojnë forcimin e bashkëpunimit me diasporën

Në kuadër të angazhimeve për zhvillim lokal, diaspora paraqet një nga partnerët më të rëndësishëm për pushtetin vendor, jo vetëm në fushën e zhvillimit social-ekonomik, por edhe të zhvillimit të infrastrukturës lokale dhe të shumë segmenteve tjera zhvillimore.

Fakti që të gjitha komunat e Kosovës kanë diasporën e vet e bënë të domosdoshëm angazhimin e pushtetit lokal në vendosjen e kontakteve dhe të bashkëpunojnë me diasporën meqenëse diaspora disponon potenciale të madha zhvillimore. Më këtë rast duhet theksuar se element të rëndësishëm paraqet madhësia dhe karakteristikat e diasporës (numri, valët e emigrimit, niveli i arsimit, punësimi, etj.), të cilat ndryshojnë, kështu që edhe mekanizmat për bashkëpunim do të ndryshojnë nga komuna në komunë.

Me qëllim të rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit me diasporën, pushteti vendor duhet të ndërmarr disa aktivitete që ndër të tjera, mund të jenë:

1. Identifikimi i prioritetëve kryesorë zhvillimore dhe projekteve specifike me qëllim të krijimit të programeve të përbashkët me diasporën (fondet e përbashkëta), praktikat inovative të zhvillimit (inkubatorët e biznesit, grupe, ndërmarrje sociale, rrjete të grave, shërbime biznesi, trajnime, etj.) dhe akterë të ndryshëm në komunitet - përfaqësues të sektorit privat, shkencës, sektorit publik (spitale, shkolla), organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile;
2. Të dhënat për diasporën - është e rëndësishme të mblidhen të dhëna për diasporën (madhësia, shpërndarja gjeografike, gjinia, mosha, arsimit, aftësitë, statusi i punësimit, statusi i pronës, kontributi në tregti, niveli i investimeve direkte dhe remitencave, përkatësia në rrjete, grupe, organizata dhe shoqata me qëllimet e zhvillimit);
3. Identifikimi i partnerëve të diasporës dhe angazhimi i tyre- është e rëndësishme të njihen iniciativat ekzistuese të diasporës - rrjetet profesionale, shoqatat, klubet

⁴⁰ “Remitancat në Kosovë- shuma të mëdha, diskutim i vogël”. Organizata GERMIN, Prishtinë , mars 2022. fq 9.

profesionale dhe të biznesit, asociacionet e ndryshme dhe të gjenden mënyra për lidhjen e tyre me nevojat zhvillimore të komunitetit lokal;

4. Identifikimi sesi dhe ku diaspora mund të japë kontribut më të madh dhe specifik në zhvillim - është e nevojshme klasifikimi i diasporës sipas profesionit, kualifikimeve dhe aftësive me qëllim të përfshirjes së tyre në zgjidhjen e sfidave të identifikuar në sektorë të caktuar - teknologjia e informacionit, shëndetësia, arsimi, etj.;

5. Zhvillimi i politikave stimuluuese që do të tërheqin diasporën për të marrë pjesë në programet e zhvillimit të komunitetit lokal duke ju siguruar qasje më të lehtë në kredi dhe mikrokredi, kushte regjistrimi të biznesit, kushte transferimi të remitencave me çmime të ulëta, etj.;

6. Identifikimi dhe adresimi i pengesave kryesore për bashkëpunimin me diasporën siç janë: mungesa e infrastrukturës, procedurat burokratike, partneritetet e dobëta, korrupsioni, mungesa e mbështetjes nga institucionet, sistemi bankar dhe ofertat e tyre, mos definimi i kompetencave në mes pushtetit lokal dhe qendror, shërbimet e dobëta konsullore, etj.;

7. Forcimi i masave dhe politikave adekuate stimulative të drejtpërdrejta (lehtësime i taksave, fondeve, resurse njerëzore, fushatat informative, ngjarjet dhe takime të diasporës në vendlindje, bursat, etj.) dhe indirekte (zhvillimi i infrastrukturës, zvogëlimi i ngarkesave burokratike, zhvillimi dhe avancim i partneritetit, zhvillimi i instrumenteve stimuluuese të biznesit);

8. Ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për të punuar me diasporën. Me këtë rast shkëmbimi i përvojave me vendet e tjera që kanë zhvilluar bashkëpunim të mirë me diasporën e tyre do të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e këtij kapaciteti, si dhe lidhjen e diasporës me zhvillimin më të gjerë, politikën e migracionit dhe kontekstin kërkimor;

9. Sigurimi i koherencës së politikave - është e rëndësishme të sigurohet koherenca e politikave ndaj diasporës në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, por edhe koherencë të politikave vendore me politikat e vendeve të destinacionit në të gjitha nivele. Është gjithashtu e nevojshme të sigurohet përputhshmëria e politikave ndaj diasporës me politikat zhvillimore;

10. Përfshirja e përfaqësuesve të diasporës në procesin e konsultimit gjatë përgatitjes së dokumenteve të planifikimit dhe politikave publike - të gjitha këto aktivitete kërkojnë që komuna të ketë një qasje proaktive ndaj diasporës, ndërsa kontaktin dhe bashkëpunimin me diasporën ta trajtojë si proces dialogu mes dy palëve⁴¹.

Me qëllim të bashkëpunimit dhe suksesit është e rëndësishme që pushteti lokal t'i trajtojë emigrimin dhe diasporën si burim dhe mundësi zhvillimi që duhet të përfshihet në dokumentet strategjike lokale. Gjithashtu, bashkëpunimi është i domosdoshëm, si në atë horizontal (shërbimet lokale, departamentet e administratës komunale, përfaqësues të pushtetit lokal, etj.) dhe në nivel vertikal (bashkëpunimi me të gjitha institucionet që kanë çfarëdo lidhje me diasporën qoftë në nivel lokal apo qendror).

Pushtetet vendore mund të përdorin një sërë mekanizmash për të inkurajuar investimet e diasporës. Krahas investimit klasik të kapitalit për hapjen e biznesit ose blerjen e aksioneve të kompanive në vendin e prejardhjes, pushtetet lokale duhet të mbështesin edhe partneritetin publiko-privat, i cili si investim nuk është përdorur sa duhet nga pushteti qendror dhe fare nga ai lokal. Partneriteti publik-privat është një bashkëpunim afatgjatë ndërmjet partnerit publik dhe privat (i cili mund të jetë edhe një përfaqësues nga diaspora me përvojë në fushën e caktuar) për të siguruar financim, ndërtim, rindërtim, menaxhim ose mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe objekteve të tjera me rëndësi publike dhe ofrimin e shërbimeve me rëndësi publike.

Fatkeqësisht shumë nga aktivitete e lartcekura që synojnë forcimin e bashkëpunimit me diasporën në Kosovë mungojnë edhe në nivel qendror, ndërsa në nivel lokal pothuajse nuk ekzistojnë fare. Prandaj, është koha e fundit që institucionet e nivelit qendror, e posaçërisht ato të nivelit lokal, të

⁴¹ Ionescu, D. "Engaging Diasporas as Development Partners for Home and Destination Countries: Challenges for Policymakers". IOM Migration Research Series 26. Geneva 2006.

ndërmarrin masa drejt avancimit të bashkëpunimit me diasporën e cila paraqet potencial shumë të madh të zhvillimit dhe nga gjendja "mundësi e madhe, përfitim i vogël" të shndërrohet në "mundësi e madhe, përfitim i madh".

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e nivelit qendror dhe lokal, duhet që investitorët nga diaspora vendore ti trajtojnë me prioritet e jo si praktikant e deri tanishme kur janë trajtuar si të gjithë investitorët tjerë të huaj.

Objektiv madhor i qeverisë së Kosovës mbetet që kapitalin njerëzor që ka Kosova ta orientojë në zhvillimin e vendit, ku një pjesë të madhe të rëndësisë e zënë pa diskutim të rinjtë. Fakti se afër gjysmën e diasporës kosovare e përbëjnë të rinjtë (grup moshat 15-39 vjeç përbëjnë 45.8%⁴²) e bën të domosdoshëm bashkëpunimin në mes këtyre dy kategorive me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe përvojave mes vete. Me rëndësi është edhe shfrytëzimi i mundësive të lidhjes së të rinjve me shoqatat në diasporë dhe projektet që mund të realizohen ku vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet intensivimit të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe diasporës.

Udhëzimet për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe shoqatave nga diaspora	
✓	Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse e kornizës ligjore, politikave dhe praktikës për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të rinjve nga diaspora në procesin e vendimmarrjes dhe zhvillimin e politikave rinore.
✓	Identifikimi dhe përfshirja e të rinjtë nga diaspora në këshillat rinore lokale dhe në Këshillin Kombëtar.
✓	Mbështetja e proceseve të themelimit të shoqatave rinore nga diaspora
✓	Përfshirja e të rinjve nga diaspora në proceset e zhvillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të planeve lokale rinore
✓	Mbështetja e zhvillimit dhe zbatimit të projekteve që kanë të bëjnë me inkurajimin e bashkëpunimit me të rinjtë nga diaspora.
✓	Zhvillimi i një modeli për lidhjen e sipërmarrësve të rinj nga diaspora me të rinjtë nga Kosova ose komunat me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe mbështetjes këshilluese.
✓	Nxitja e vullnetarizmit të të rinjve nga diaspora me mbështetjen e zyrave komunale për rininë dhe rrjetëzimin me bashkëmoshatarët nga vendlindja
✓	Përfshirja të rrjeteve/ shoqatave akademike lokale dhe lidhjen me të rinjve nga diaspora.
✓	Vendosja e bashkëpunimit dhe koordinimit të programeve të informacionit dhe shërbimit rinore në nivel lokal me programe të tjera, shërbime dhe struktura për të rinjtë nga diaspora
✓	Sigurimi i përmbajtjes për të rinjtë në media dhe e përshtatja me nevojat e identifikuar të të rinjve dhe tema me interes për të rinjtë nga diaspora, me shkëmbimin e informacioneve dhe nxitjen e bashkëpunimit me të rinjtë nga vendi.
✓	Ofroni mbështetje për programet e krijuara dhe të zbatuara nga të rinjtë e diasporës në bashkëpunim me të rinjtë nga vendlindja me qëllim të forcimit të lidhjeve, promovimin dhe ruajtjes së traditës dhe kulturës të vendlindjes.

Tabela 3. Udhëzimet për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe shoqatave nga diaspora

Këto rekomandime tregojnë për disa nga format e bashkëpunimit ku mund të kontribuojë niveli lokal në krijimin e nismave konkrete zhvillimore duke nxitur bashkëpunimin e të rinjve nga mërgata me ata në vendlindje dhe institucionet lokale.

5.6. Institucionet (e mundshme) e nivelit lokal për bashkëpunim me diasporën

Pushteti lokal mund të rregullojë fushën e bashkëpunimit me diasporën në disa mënyra, në varësi të nevojave, madhësisë së diasporës dhe burimeve njerëzore e institucionale. Për bashkëpunim me diasporën mund të jenë përgjegjës institucionet ekzistuese ose të cilat mund të themelohen siç janë:

⁴² "Rezultatet preliiminare të regjistrimit të diasporës", Ministria e Diasporës, Prishtinë 2017, fq 55.

1. Asociacioni i Komunave të Kosovës;
2. Këshilli (Kuvendi i komunës) për bashkëpunim me diasporën;
3. Anëtarët e kuvendit komunal, përgjegjës për bashkëpunimin me diasporën;
4. Këshilltarët për bashkëpunim me diasporën;
5. Nënkryetari i komunës/përgjegjës për bashkëpunimin me diasporën;
6. Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal;
7. Zyra për Bashkëpunim me Diasporën;
8. Emërimi i një personi tjetër juridik i cili mund të jetë staf i komunës ose edhe punësim i ri;
9. Asociacioni i disa njësive të pushtetit vendore;
10. Krijimi i një mekanizmi të përbashkët nga disa komuna (në nivel regjional) për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve me diasporën në komunat gjegjëse.

6. Sfidat kryesore për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit

Sfida kryesore për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit në nivel qendror, e posaçërisht në atë lokal është:

- Njohuritë e pamjaftueshme të temës së migrimit dhe zhvillimit dhe lidhjes së tyre,
- Mungesa e kapaciteteve institucionale lokale për përfshirjen e diasporës në proceset zhvillimore,
- Mjedisi kompleks (shpeshherë i papërshtatshëm), administrativ (procese të tej zgjatura për pajisje me leje dhe dokumentacion përcjellës), ekonomik (varfëria, pengesat korruptive, etj.) dhe politik.

Mungesa e njohurive dhe kapaciteteve institucionale për këtë fenomen të rëndësishëm në planin afatgjatë përcillet edhe në mos përfshirjen dhe trajtimin e tij nga administrata lokale në dokumentet strategjike gjatë planifikimit të politikave përkatëse publike. Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për realizimin e kërkimeve dhe analiza shkencore lidhur me mundësinë e përfshirjes së migracionit në politikën e zhvillimit. Përveç kontributeve financiare për mirëqenie sociale, është e nevojshme edhe orientimi në mundësitë që ofron diaspora në zhvillim, pastaj kapitalit njerëzor dhe social i diasporës të cilit duhet kushtuar vëmendjen që e meriton – si në mesin e studiuesve, ashtu edhe në mesin e politikbërësve.

Sfidë tjetër për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit është edhe mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndër-sektorial brenda dhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes në Kosovë, të cilat në çfarëdo mënyre punojnë për çështjet e diasporës dhe zhvillimit. Gjithashtu, mungon edhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e autoriteteve dhe institucioneve të vendeve pritëse të mërgatës kosovare.

Komunikimi me emigrantët është i pamjaftueshëm, sporadik dhe informal, shpesh me kërkesë dhe iniciativë të vetë emigrantëve. Emigrantët nuk marrin pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike dhe monitorimin e zbatimit të tyre, shumë pak në bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe akademike.

Ka edhe vështirësi në krijimin e besimit dhe mobilizim të emigrantëve, i cili është rezultat i një sërë pengesash që hasin nismat e tyre. Praktikën e deritanishme (fatkeqësisht të shpeshta) tregojnë për barrierat administrative dhe institucionale për të bërë biznes që do të duhej të tejkalohen përmes politikave ndaj diasporës në nivel shtetëror, të cilat më pas do të reflektohen në politikën lokale, aty ku bëhen investime.

Përveç sfidave të brendshme ekzistojnë edhe sfida nga vet emigrantët për shndërrimin e tyre në akterë efektivë për zhvillim lokal që mund të përmbliken në tre grupe faktorësh që janë: gatishmëria/vullneti, mundësia dhe kapaciteti.



Grafiku 14. Sfidat kryesore për vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit

Kosova në aspektin institucional, fatkeqësisht, ka bërë një hap prapa me shuarjen e Ministrisë së Diasporës dhe fuzionimin e saj në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila do të ishte strumbullar i të gjitha aktiviteteve për bashkëpunim me diasporën duke përfshirë edhe inkorporimin e konceptit të migrimit dhe zhvillimit në politikat sektoriale në Kosovë dhe vendosjen e një mekanizmi gjithëpërfshirës koordinues për migracionin dhe zhvillimin që do ta përmirësonte edhe bashkëpunimin ndër-institucional në të gjitha nivelet e qeverisjes duke mundësuar përgjigjen në sfidat kryesore që lidhen me vënien e potencialit të migracionit në funksion të zhvillimit në Kosovë në përgjithësi dhe nivelin lokal në veçanti⁴³.

6.1. Rekomandimet bazë për përfshirjen e konceptit të migracionit në politikat zhvillimore

- Për të përfshirë konceptin e migracionit në politikat e zhvillimit në Kosovë është e rëndësishme që diaspora të kuptohet, jo vetëm si burim financiar, por shumë më tepër se kaq, të shihet si burim njerëzor (arsim, trajnim, aftësi dhe njohuri), financiar dhe sipërmarrës (remitenca, investime të huaja direkte, tregti, kursime, investime në biznes, pasuri të paluajtshme, ndihma humanitare, etj.), social (rrjetet e diasporës, shoqatat, asociacionet profesionale që bashkëpunojnë me vendin e origjinës dhe vendin pritës, lidhjet miqësore dhe familjare, lidhjet me komunitetin dhe institucionet lokale, lidhjet profesionale), emocional (angazhim, nostalgji, vullnet i mirë) dhe lokal (njohuri e kontekstit lokal dhe lidhje e veçantë me vendin e origjinës). Këto burime mund të japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin human dhe ekonomik të vendit.
- Institucionet lokale dhe qendrore në Kosovë duke pasur parasysh faktin se personi që planifikon të emigrojë kalojnë nëpër faza të ndryshme edhe efekte të ndryshme, kërkojnë edhe politika të ndryshme.
- Kosova (kuptohet edhe njësitë përbërës të saj – komunitat) ka potencial të madh zhvillimi në emigracion prandaj:
 - duhet të synohet për lidhje shumë më mirë të politikave zhvillimore në vend (lokale e qendrore) dhe harmonizimin më të mirë të mundësive që ofron mërgata,
 - institucionet kompetente duhet të inkurajohen në krijimin dhe përdorimin e statistikave për migracion, por edhe shfrytëzimin e kapaciteteve vendore e ndërkombëtare, kërkime akademike të cilat objekt trajtimi kanë migrimin dhe zhvillimin, si dhe inkurajimin dhe alokimin e burimeve financiare për politikave që përfshijnë konceptin e migrimit dhe zhvillimit,
 - gjithashtu, në rast të krijimit të politikave të reja duhet të bëhet një vlerësim i efekteve të politikave tashmë të zbatuara nga institucionet vendore e ndërkombëtare për të konstatuar se me cilat politika duhet të vazhdohet (nëse ka

⁴³ "Preporuke za uvrštavanje koncepta migracija i razvoja u izradu i realizaciju javnih politika u Bosni i Hercegovini", Ministarstvo za ljudska prava i izbjeglice Bosne i Hercegovine fq 22-23.
E qasshme: <https://diaspora.mhrr.gov.ba/wp-content/uploads/2018/09/Preporuke-finalna-verzija-prelom-19jul2017.pdf>

- të tilla) apo çfarë duhet përmirësuar ose në krijimin dhe zbatimin e politikave të reja për të arritur efektin maksimal.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes ka një rëndësi të madhe për përfshirjen e konceptit të migracionit në politikat zhvillimore në Kosovë:
 - është e rëndësishme ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimit për nëpunësit civil nga fusha të ndryshme të sektorit ekonomik dhe social dhe në këtë mënyrë të fillohet procesi i ndërtimit të kapaciteteve brenda administratës komunale mbi konceptin e migracionit dhe zhvillimit dhe specifikat e tij që lidhen me sektorë dhe politika të veçanta,
 - ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimit kërkon domosdoshmërisht përfshirjen e konceptit të migrimit dhe zhvillimit në politikat sektoriale dhe duhet të zhvillohen së bashku me përfaqësuesit e diasporës duke shfrytëzuar këtu edhe komuniteti akademik në Kosovë, por edhe në diasporë;
 - rolin kyç në bashkërendimin e këtij procesi duhet ta ketë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori për Emigracionin, por edhe Ministria e Pushtetit Lokal si institucioni kryesor për bashkëpunim me nivelin lokal, etj. Megjithatë, shpërndarja e detyrave në shumë institucione paraqet problem sepse kërkon koordinim të mirë aktivitetesh që fatkeqësisht mungon brenda institucioneve të Kosovës;
 - angazhimi i institucioneve qendrore në zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e njohurive të nëpunësve civil mbi konceptin e migracionit dhe zhvillimit.
 - Është e nevojshme të inkurajohet zhvillimi i programeve akademike që studiojnë fenomenin e migrimit në mënyrë ndërdisiplinore. Fenomeni i migracionit mund të shihet edhe nga aspekti ekonomik, sociologjik, kulturor, psikologjik, juridik, filozofik dhe politik dhe secila prej këtyre fushave shkencore është e rëndësishme për studimin e fenomenit të migrimit dhe zhvillimit. Me këtë rast, si hap i duhur do të ishte krijimi i një programi universitar ose pasuniversitar lidhur me migrimin dhe zhvillimin.
 - Element i rëndësishëm për krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e suksesshëm të politikave publike janë edhe disponimin e statistikave sa më të sakta dhe gjithëpërfshirëse të migracionit.
 - nëpërmjet procesit të konsultimeve dhe bashkëpunimit, është e nevojshme të krijohen mundësi për përmirësimin e bashkëpunimit ekzistues në kontekstin e migrimit dhe zhvillimit.
 - mbështetja e kërkimeve cilësore nga sektori akademik dhe shoqëria civile në lidhje me fenomenin migrim - zhvillim është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mund të jetë me rëndësi të madhe për t'u trajtuar dhe konsideruar, si nga niveli qendror edhe ai lokal, sidomos me rastin e përgatitjes së dokumenteve strategjike zhvillimore.
 - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori për Emigracionin, në bashkëpunim me agjencitë dhe institucionet e tjera (ASK), mund të luajë një rol të rëndësishëm në inicimin e një debati në lidhje me monitorimin statistikor të migracionit në kontekstin e zhvillimit.
 - Vendosja e komunikimit me diasporën, përkatësisht shoqatat e saj, duhet të jetë një nga prioritetet e institucioneve të pushtetit lokal dhe qendror të Kosovës. Hartimi i një plani për komunikim dhe bashkëpunim me diasporën në lidhje me aktivitetet zhvillimore të përcaktuara qartë në nivel lokal dhe qendror siç janë: Ministria e Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori për Emigracion dhe Refugjatë, por edhe organeve të tjera siç janë misionet diplomatike dhe konsullore të cilat duhet të forcohen me synimin e qartë për të piketuar diasporën me qëllim të shkëmbimit të informacionit dhe njohurive me emigrantët.
 - Është e domosdoshme të forcohen kapacitetet dhe të vendoset bashkëpunim më efikas me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të rritet angazhimi dhe përkushtimi i tyre për përfshirjen e konceptit të migrimit në politikat zhvillimore të Kosovës dhe komunave gjegjësisht bashkëpunimin me diasporën.

7. Rekomandimet

Kosova, si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal, nuk i shfrytëzon mundësitë që ofrojnë emigrimet e popullsisë për zhvillim, sidomos për zhvillim lokal. Me qëllim të shndërrimit të emigrimeve në potencial të mirëfilltë të zhvillimit lokal nga *“mundësi shumë e madhe, përfitim shumë i vogël”* në *“mundësi shumë e madhe, përfitim shumë të madh”*, është e nevojshme që:

1. Emigrimi dhe të dhënat mbi emigrimin të jenë në qendër të vendimmarrjes në sektorët zhvillimor të vendit dhe veçanërisht në nivelin lokal ku është i domosdoshëm edhe krijimi i mekanizmave për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve me diasporën,
2. Të përgatitet një udhëzues për rritjen e bashkëpunimit në mes pushtetit lokal dhe diasporës dhe të organizohen trajnime në nivel lokal me institucionet relevante lokale për informimin rreth mundësive të bashkëpunimit me diasporën dhe involvimit të saj në zhvillimin lokal,
3. Të krijohen politika inkurajuese dhe lehtësuese për investim të diasporës, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, duke mos e reduktuar emigracionin dhe diasporën vetëm si potencial ekonomik, por edhe si potencial arsimor, shëndetësor, etj., dhe krijimi i praktikave lokale mbi këto parime që do të ishin në dobi për të gjithë akterët,
4. Është e domosdoshme të punohet në përmirësimin e imazhit dhe të identifikohen dhe mënjanohe pengesat për bashkëpunimin me diasporën, si: në infrastrukturë, procedura burokratike, korrupsion, mungesë të rrjeteve mbështetëse, etj., duke nxitur zhvillimin e instrumenteve të përgjithshme stimuluese në fushat e kompetencave të autoriteteve lokale - uljen e çmimit të tokës ndërtimore, dhënien e lejeve të nevojshme, uljen e kostove të shërbimeve për investime të caktuara, e të ngjashme. Është po aq e rëndësishme të sigurohet koherenca e politikave të diasporës në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal,
5. Integrimi i migrimeve si pjesë përbërëse e planeve dhe strategjive zhvillimore, si në nivel qendror e posaçërisht në nivel lokal - marrja e sugjerimeve dhe ideve të diasporës me rastin e përgatitjes së planeve, strategjive dhe dokumenteve tjera zhvillimore në nivelin lokal. Është e nevojshme t'i qasemi migracionit dhe diasporës si një potencial zhvillimi me rastin e përgatitjes dhe hartimin e politikave lokale, si dhe dokumenteve të ardhshme strategjike të cilat duhet të reflektohen në lidhjen e politikave të migracionit dhe zhvillimit. Në përgatitjen e dokumenteve strategjike zhvillimore, si në nivelin lokal (në veçanti) ashtu edhe në atë qendror, duhet më tepër të përfshihen edhe ekspertët dhe institucionet akademike,
6. Shfrytëzimi i praktikave të mira vendore dhe ndërkombëtare në krijimin e politikave për përmirësim të bashkëpunimit me diasporën dhe përshtatja me specifikat lokale, si dhe promovimin e praktikave të mira të përfshirjes së diasporës në zhvillimin lokal do të jenë ndihmesë e madhe në ngritjen e bashkëpunimit e cila duhet të promovohet. Është veçanërisht e rëndësishme që përfaqësuesit e diasporës të konsultohen në të gjitha fazat e përcaktimit të projekteve dhe jo diaspora të trajtohet si burim për investime, pasi dokumentet strategjike lokale të përgatiten dhe të identifikohen dhe përcaktohen projektet investuese,
7. Përmirësimi i statistikave të migracionit, sidomos atyre të nivelit lokal - shfrytëzimi i burimeve lokale për krijimin e bazave të të dhënave për potencialin migrator të komunave. Më këtë rast, është e nevojshme të inkurajohet puna e përbashkët e akterëve lokal për mbledhjen sistematike të të dhënave për diasporën lokale dhe përfshirjen e tyre në bazat e të dhënave zyrtare komunale, duke pasur parasysh faktin se njohja e diversitetit të diasporës mund të ndihmojë në identifikimin e burimeve të ndryshme të anëtarëve të diasporës. Ngjarje, si ditët e diasporës, të cilat organizohen në shumë komuna të Kosovës, mund të jenë një hap i mirë fillestar në identifikimin e burimeve të diasporës.
8. Institucioneve qeveritare në bashkëpunim me ato financiare duhet të krijojnë politika të përbashkëta në mënyrë që kosto e shërbimeve (dërgimit të remitencave nga diaspora) të jetë sa më e favorshme,
9. Në të gjithë hapat e ngritjes së bashkëpunimit në mes niveleve lokale dhe diasporës, është e nevojshme që një vëmendje e veçantë të ju kushtohet të rinjve të cilët përbëjnë pjesën më të madhe dhe kapacitetin më të madh për zhvillim.

10. Është e nevojshme që ky dokument t'u prezantohet sa më shumë vendimmarrësve në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë në mënyrë që të merret mbështetje institucionale për përfshirjen sistematike dhe gjithëpërfshirëse të konceptit të migrimit në politikat zhvillimore në Kosovë, posaçërisht në nivelin lokal.

